

1.3.3 Segmenti Jugor-Qendror

Kjo pjesë përfshin një brez më të gjerë hapësirash të hapura, që lidhen drejtpërdrejt me plazhin publik dhe zonat e ecjes. Aktualisht ajo përdoret në mënyrë të lirshme për lëvizje këmbësorësh, ndalesa afatshkurtra dhe aktivitete të përkohshme gjatë verës. Struktura urbane është më pak e zhvilluar krahasuar me segmentet veriore, por kjo krijon mundësinë për fleksibilitet në përdorim dhe përfshirjen e funksioneve të reja në të ardhmen. Sasia e gjelbërimit dhe elementeve të mobilitetit është modeste, ndërsa potenciali për aktivitete sportive, rekreative apo komunitare mbetet i lartë.



Figura 5 -Segmenti Jugor-Qendror.

1.3.4 Segmenti Jugor

Segmenti jugor është më pak i ndërtuar dhe ka një karakter më të qetë e më natyror. Ai përfshin sipërfaqe të hapura pranë vijës së ujit dhe ofron hapësira të përshtatshme për ecje, çlodhje dhe qëndrime të shkurtra. Elementet e infrastrukturës publike janë të pranishëm në një shkallë të kufizuar, ndërsa gjelbërimi është më shumë spontan sesa i strukturuar. Pikërisht kjo karakteristikë e bën zonën të veçantë dhe me potencial për zhvillime të orientuara drejt peizazhit, mirëqenies dhe aktiviteteve të buta rekreative që mund të ndodhin gjatë gjithë vitit.



Figura 6 - Segmenti Jugor

Zona e Plazhit të Durrësit paraqet një zhvillim urbanistik të ndërlikuar dhe gradual, i cili pasqyron dinamikën ekonomike, sociale dhe demografike të qytetit përgjatë dekadave të fundit. Analiza e shpërndarjes së strukturave të ndërtuara sipas periudhave kohore tregon qartë procesin e transformimit të kësaj zone nga një hapësirë periferike dhe rekreative në një pol të rëndësishëm urban dhe turistik të qytetit.

Pjesa më e vjetër e ndërtimit përqendrohet kryesisht në zonat pranë qendrës historike dhe portit, ku ndërtesat e ndërtuara para viteve 1960 janë ende të pranishme dhe përfaqësojnë bërthamën fillestare të zhvillimit të qytetit. Këto struktura kanë shpesh vlera historike dhe arkitektonike, por gjithashtu përbëjnë sfida në aspektin e infrastrukturës dhe përshtatjes me nevojat bashkëkohore. Gjatë periudhës 1961–1980, zhvillimi u zgjerua gradualisht në drejtim të lindjes dhe jugut, duke përfshirë edhe segmentet e para të zonës së plazhit, ku filluan të shfaqen komplekset e para të banimit dhe objektet publike të ndërtuara me logjikën urbanistike të kohës.

Një rritje më e ndjeshme e ndërtimit vërehet pas viteve 1990, periudhë e cila shënon një transformim të madh në strukturën urbane të Durrësit si pasojë e zhvillimeve socio-ekonomike të pastranzicionit. Zona e plazhit u bë një prej destinacioneve kryesore për ndërtimet e reja, duke përfshirë ndërtesa banimi, struktura hoteliere dhe objekte shërbimi që iu përgjigjën kërkesës së lartë për turizëm dhe përdorim sezonal. Gjatë kësaj periudhe, zhvillimi shpesh është karakterizuar nga intensiteti i lartë ndërtimi dhe mungesa e planeve të detajuara urbane, gjë që ka sjellë sfida në organizimin e hapësirave publike dhe infrastrukturës mbështetëse.

Në periudhën 2001–2011, ritmi i ndërtimit është intensifikuar edhe më tej, veçanërisht përgjatë vijës bregdetare, ku janë ngritur struktura moderne turistike dhe rezidenciale. Ky zgjerim i shpejtë ka ndryshuar ndjeshëm morfologjinë urbane të zonës së plazhit, duke e transformuar atë nga një hapësirë me karakter rekreativ në një zonë të përzier funksionesh që përfshin banim, turizëm, shërbime dhe rekreacion. Megjithatë, ky zhvillim intensiv shpesh ka qenë i pakoordinuar, duke sjellë sfida në lidhje me menaxhimin e infrastrukturës, hapësirave publike dhe mbrojtjen e vijës bregdetare.

Në përfundim, struktura ndërtimore e zonës së Plazhit të Durrësit është pasqyrë e qartë e fazave të zhvillimit të qytetit dhe ndryshimeve shoqërore që ai ka përjetuar gjatë gjashtë dekadave të fundit. Nga një zonë periferike dhe e pashfrytëzuar, ajo është shndërruar në një nga hapësirat më dinamike dhe me potencial më të lartë zhvillimi në qytet. Sfida kryesore për të ardhmen mbetet balancimi ndërmjet ruajtjes së karakterit bregdetar dhe natyror të zonës, përmirësimit të cilësisë urbane dhe menaxhimit të rritjes së mëtejshme ndërtimore në mënyrë të qëndrueshme.

1.4 Qellimi i projektit

Ky projekt synon transformimin e vijës bregdetare të qytetit të Durrësit në një destinacion bashkëkohor turistik, rekreativ dhe urban, përmes ndërhyrjeve arkitekturore e urbane të planifikuara me kujdes. Ai përfshin zgjerimin e plazhit ekzistues, krijimin e një parku linear të gjelbër përgjatë vijës detare, zhvillimin e hapësirave publike multifunkionale dhe integrimin e infrastrukturës së re rekreative e sportive. Gjatësia e zonës së ndërhyrjes është rreth 2.8 km, me një zgjerim të bregut deri në 100 metra drejt detit, duke krijuar hapësira të reja publike për banorët dhe vizitorët. Ai do të përfshijë:

- Hapësira të gjelbra me pemë mesdhetare, zona pushimi dhe shëtitore.
- “Green Coves” – nyje natyrore dhe hapësira të vogla intime përgjatë bregut, që krijojnë lidhje të drejtpërdrejtë mes qytetit dhe detit.
- Ndërthurje të natyrës me funksione urbane si bare, klube plazhi dhe restorante. Ne kapituajt ne vijim janë dhene ne menyre te permbledhur te gjitha studimet e bera per zhvillimin e ketij projekti.

2 STUDIMI TOPOGRAFIK

2.1 Hyrje

Zona që do të rilevohet ndodhet në qytetin e Durrësit, zë një sipërfaqe rreth 544326m², e cila përfshin zonën nga porti i Durrësit deri tek Kavalishenca.

Ky projekt ka për qëllim të transformojë zonën bregdetare të qytetit të Durrësit në një destinacion bashkëkohor turistik, rekreativ dhe urban, përmes ndërhyrjeve arkitekturore dhe urbane të planifikuara me kujdes. Ai përfshin zgjerimin e plazhit ekzistues, krijimin e një parku linear të gjelbër përgjatë vijës bregdetare, zhvillimin e hapësirave publike shumëfunktionale dhe integrimin e infrastrukturave të reja rekreative dhe sportive. Gjatësia e zonës së ndërhyrjes është rreth 2.8 km, me një zgjerim të vijës bregdetare deri në 100 metra drejt detit, duke krijuar hapësira të reja publike për banorët dhe vizitorë.

Zona shtrihet ndërmjet koordinatave gjeografike:

- PIKA A : N = 4574970.10m E = 371759.92m
- PIKA B : N = 4574821.04m E = 371684.10m
- PIKA C : N = 4572905.81m E = 374166.22m
- PIKA D : N = 4573024.48m E = 374327.76m



2.2 Azhornimi Topografik

Punimet topografike per projektin ne fjale u kryen mbi bazen e kerkesave teknike te pergjithshme dhe specifike te parashikuara nga Klienti

Para fillimit te punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme hartografike, gjeodezike si dhe paisjet perkatese. I gjithe procesi i rilevimit konsiston ne krijimin e nje harte digjitale me nje siperfaqe ~34227m², me nisje afer rruges 8-Marsi duke u zhvilluar me tej ne drejtim te rruges Demokracia. E gjithe puna filloi me rikonjicionin e terrenit dhe ndertimin e poligonit te shperndare ne menyre te rregullt ne zonen e interesit (te cilet do te perdoren dhe gjate ndertimit te vepres). Bazamenti gjeodezik ka sistemin koordinativ UTM 34N .

Punet topografike per ndertimin e kesaj harte konsistojne ne hapat e meposhtme:

- Ndertimi i Poligonit, Nivelacioni & Matja e tyre me GPS
- Rilevimi i detajuar
- Perpunimi i te dhenave dhe hartimi i hartes digjitale

3 STUDIMI GJEOLOGJIK

3.1 Hyrje

Ky projekt ka për qëllim të transformojë zonën bregdetare të qytetit të Durrësit në një destinacion bashkëkohor turistik, rekreativ dhe urban, përmes ndërhyrjeve arkitekturore dhe urbane të planifikuara me kujdes. Ai përfshin zgjerimin e plazhit ekzistues, krijimin e një parku linear të gjelbër përgjatë vijës bregdetare, zhvillimin e hapësirave publike shumëfunktionale dhe integrimin e infrastrukturave të reja rekreative dhe sportive. Gjatësia e zonës së ndërhyrjes është rreth 2.8 km, me një zgjerim të vijës bregdetare deri në 100 metra drejt detit, duke krijuar hapësira të reja publike për banorët dhe vizitorët.

Ky raport mbulon të gjithë informacionin e punimeve kërkimore gjeologjike të kryera për kete faze.

3.2 Qellimi I Studimit

Qellimi i këtij studimi është për studimin e e përgjithshëm të zonës për kete faze të projektimit. Janë marrë në shqyrtim materialet studimore të të gjithë zonës. Zona e studimit shtrihet nga porti i Durrësit deri tek Kavalishenca.

3.3 Përshkrimi I Gjeologjisë Në Zonën E Studimit

Depozitimet detare-lagunore janë depozitime nga prurjet e perrenjve dhe lumenjve që derdhen në gjirin e Durrësit, përpunimi i tyre nga veprimtaria e detit dhe depozitimi pranë vijës detare në periudha të gjata gjeologjike duke formuar kështu shtresa rerash, surerash ngjyre gri hiri, në gjire të vecuara të bregdetit ka edhe depozitime argjilore lymore lagunore ngjyre gri, gjithashtu në faza të ndryshme janë depozituar edhe materiale organike lështeriku në forme gjurmesh, fragmente apo edhe ndershtresash me ngjyre gri të zeze. Depozitimet detare dhe lagunore në përgjithësi janë pak deri mesatarisht të ngjeshura dhe janë gjithmone me lageshtire deri të ngopura me ujë.

Në rajonin e Durrësit takohen depozitimet Neogjenike të Mesinianit dhe të Pliocenit (Seria Helmësi) dhe depozitimet Kuaternare.

Depozitimet e Mesinianit dalin kryesisht në veri-perëndim të qytetit të Durrësit dhe kanë dalje të drejtpërdrejtë në detin Adriatik. Pakot kryesore të këtyre depozitimeve janë:

N13m(c) - përfaqëson një pako argjilo-alevrolitike. Argjilat paraqiten më kompakte, me ngjyrë hiri në bezhë. Trashësia varion 150 – 300 metër.

N13m(d) - Përfaqëson një pako argjilash gips mbajtëse. Midis copërave të gipseve janë ndeshur me shumicë dhe copëra alabastre. Rrallë takohen edhe thjerrëza ranorësh. Trashësia është 300 – 500 metra.

Depozitimet Pliocjenike zënë pothuajse të gjithë sipërfaqen e kodrave të Durrësit duke patur, nga Durrësi deri në Currila, një kontakt të drejtpërdrejtë me detin Adriatik. Nga Currilat dhe më në veri (në pjesën ekstreme perëndimore) kontaktojnë me depozitimet Mesiniane. Depozitimet Pliocjenike ndahen në dy formacione kryesore: Seria Helmësi (N2h) dhe Seria Rrogozhina (N2r).

Në rajonin e qytetit të Durrësit të janë ndeshur vetëm formacionet e Serisë Helmësi (N2h). Këto depozitime ndahen në tre pako litologjike, që nga poshtë lart janë:

N2h(a). – Pakua ranoro- konglomeratike e cila në pjesën e poshtme përfaqësohet nga depozitime ranoro-konglomeratike bazale. Konglomeratet janë të pangopura dhe shprehin fillimin e trangresionit të Pliocenit. Konglomeratet janë disi të çimentuara dhe të ndërthurur me argjila dhe ranorë. Ranoret janë shtresorë dhe disi kompaktë. Më sipër prerja bëhet më argjilo- ranore. Trashësia është nga 350 – 600 metra.

N2h(b). – Pakua argjilo-ranore dhe alevrolito- ranore.

Në këtë pako kryesisht mbizotërojnë argjilat, të cilat janë jo shumë kompakte deri te buta. Janë ngjyrë hiri dhe kanë përmbajtje materiali alevrolitor. Ranorët janë kryesisht thjerrëzorë, me përmasa të thjerrëzave 20- 30 m dhe më shumë në disa raste. Alevrolitet janë masivë deri në shtresorë kompaktë. Trashësia varion nga 600 – 1000 metër.

N2h(c). – Pako argjilo- alevrolitike. Formacionet argjilo-alevrolitike të kësaj pakoje janë kompaktë, ngjyrë hiri në bezhë. Argjilat kanë si karakteristike thyerjen guackore deri ciflore e vende vende shtresore me përmbajtje makrofaune. Në brendësi të kësaj pakoje janë ndeshur thjerrëza të rralla ranorësh. Trashësia e kësaj pakoje është nga 200 – 700 metër.

Depozitimet Kuaternare kanë përhapje të gjerë në qytetin e Durrësit. Ato zënë fushën e Durrësit, zonat plazhore dhe rrëzat e kodrave. Depozitimet Kuaternare paraqiten të ndryshme, në funksion të vendit ku janë formuar. Në fushën e Durrësit ndeshen kryesisht depozitime lagunore-kënetore, në rrëzat e kodrave ndeshen kryesisht depozitime kolvionale, proluvionale e deluvionale ndërsa në bregun detit, në zonat plazhore, ndeshen depozitime detare.

Q4d – Depozitimet Kuaternare kolvionale - deluvionale dhe proluviale zënë një sipërfaqe të vogël rrëzë kodrave të Durrësit. Ato përbehen nga argjila, alevrite. Trashësia deri 30 metra.

Q4k – Depozitimet Lagunore – kënetore zënë pothuajse të gjithë fushën e Durrësit, ato përbehen nga argjila, alevrite, rëra te imta, mbeturina dhe rrënjë bimësh. Trashësia ~ 50 metra.

Q4 – Depozitimet Kuaternare zënë pjesën e zonave plazhore të rajonit. Ato përfaqësohen nga rëra e zhure.

Rajoni i qytetit të Durrësit bën pjesë në Ultësirën Adriatike. Në këtë rajon veçohen dy struktura: Antiklinali i Durrësit dhe Sinklinali i Durrësit.

Antiklinali i Durrësit bën pjesë në trevën e rudhosur mollasike Divjakë – Ballaj – Kryevindh- Durrës - Bishti i Pallës. Përfaqësohet nga një varg kodrash, midis të cilave spikat e Durrësit.

Nga punimet sizmike është vërejtur se kjo strukturë pozitive në thellësi komplikohet dhe shoqërohet nga tektonika hedhëse dhe kundra hedhëse, të evidentuara kryesisht në krahun perëndimor të ngritjes.

Kjo trevë luan rolin e një mburoje për rajonin e Durrësit (sidomos për zonat e ulura të tij) duke zbutur efektin e veprimtarisë së dallgëve. Në sektorin e Gjirit të Durrësit deti ka mposhtur këtë mburojë duke e shkatërruar plotësisht atë. Bregdeti i kodrave të Durrësit është i ballafaquar me rrëshqitje masive, kjo për efekt të ndërtimit të argjilave të Mesinianit dhe të Pliocenit të cilat janë të prirura për rrëshqitjet dhe erozionin.

Në veri qytetit të Durrësit, në det, depozitimet detare Kuaternare shtrihen horizontalisht mbi mollaset e rudhosura Mio-Pliocenike.

Ky mospajtim strukturor krahinor i theksuar dëshmon fazën shtypëse të Pleistocenit të poshtëm në Ultësirën Adriatike. Këtu vihet re se kundër hipja e Durrësit pret madje edhe depozitimet Kuaternare detare që janë deformuar lehtë në përputhje me tavanin e nen shtrirë të depozitimeve Mio- pliocenike). Këto të dhëna demonstrojnë se deformacionet shtypese veprojnë ende në ditët tona, megjithëse jo kaq të forta si më parë. Neotektonika është shumë e zhvilluar në zonën e studiuar.

Në rrëzë të kodrës së Durrësit në drejtim jug-veri kalon një shkëputje aktive, që ndërton antiklinalin e Durrësit.

4 STUDIMI HIDROLOGJIK

4.1 Klima

4.1.1 Zona Klimaterike

Zona e studimit ndodhet brenda zonës klimatike Mesdhetare të Ultësirës. Kështu, sasia vjetore e reshjeve varion midis 950–1200 mm. Rënia e dëborës është një fenomen i rrallë dhe shtresa e qëndrueshme e dëborës pothuajse nuk vërehet kurrë. Temperaturat minimale absolute variojnë midis -3 deri në -5 °C; vetëm në raste shumë të rralla mund të regjistrohen vlera më të ulëta. Periudha me ngrica është e shkurtër dhe numri i ditëve me ngrica mund të arrijë deri në 12–15 në vit, gjatë të cilave temperaturat minimale zbresin nën 0°C.

Era fryn përgjithësisht nga dy drejtime. Gjatë sezonit të ftohtë mbizotëron era nga jugu-lindja dhe veriu, ndërsa gjatë sezonit të ngrohtë mbizotëron era nga drejtimi veriperëndimor. Shpejtësitë maksimale të erës në këtë zonë gjatë sezonit të ngrohtë arrijnë vlera prej 10–15 m/s, ndërsa gjatë sezonit të ftohtë rreth 25–30 m/s..




Figura 7 - Zonimi klimatik në rajonin e Durrësit

4.1.2 Temperatura

Temperatura e ajrit është një element i rëndësishëm klimatik, i cili pasqyron sasinë e energjisë diellore në afërsi të Tokës. Në tabelën dhe grafikën e mëposhtme paraqiten temperaturat mesatare mujore të matura në

Stacionin e Kamzës. Nga këto të dhëna vërehet se vlera mesatare maksimale arrihet në muajin korrik (23.4 °C), ndërsa vlera minimale në muajin janar (6.5 °C). Vlera mesatare për të gjithë vitin është 14.9 °C.

Table 1 Average Monthly Air temperatures

Months	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Year
Temp. °C	6.5	7.8	9.9	13.1	17.6	21.4	23.4	23.3	20.3	15.9	11.8	7.9	14.9




Figure -8 Average Monthly Air temperatures

4.1.3 Rrezatimi diellor

Në grafikën e mëposhtme paraqiten vlerat mujore të kohëzgjatjes së diellit në orë për stacionin e Kamzës. Nga këto të dhëna vërehet se vlerat maksimale të këtij elementi regjistrohen në korrik, ndërsa vlerat minimale në dhjetor. Vlera mesatare për gjithë vitin është 2613 orë




Figura 9 - Numri mesatar mujor i oreve me diell

4.1.4 Lageshtia

Lagështia e ajrit është gjithashtu një element meteorologjik i rëndësishëm, i cili ndikon në trafikun rrugor.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet shpërndarja ndërvjetore e këtij elementi. Nga këto të dhëna vërehet se vlera mesatare e lagështisë regjistrohet gjatë sezonit të dimrit (79–80%), ndërsa vlera minimale gjatë sezonit të ngrohtë (63–67%). Gjithashtu paraqitet shpërndarja ndërvjetore e lagështisë relative, ku shihet se vlerat e këtij elementi luhaten brenda një intervali të vogël.




Figura 10 - Lageshtia relative

Lakorja që paraqet lagështinë mesatare në 2:00 pasdite paraqet të njëjtën performancë si ajo e lagështisë mesatare, por me vlera rreth 5% më e ulët. Konkretnisht, vlerat e këtij indeksi arrijnë minimumin në korrik dhe gusht (rreth 57%) dhe maksimumin në nëntor (rreth 63%).

4.1.1 Reshjet

Reshjet janë një element i rëndësishëm për projektimin, veçanërisht të dhënat mbi intensitetin e reshjeve. Vlerat mujore të reshjeve për një vit mesatar paraqiten në tabelën më poshtë, të ndjekura nga paraqitja grafike e shpërndarjes së tyre ndërvjetore.

Nga këto të dhëna vërehet se vlerat mesatare maksimale regjistrohen gjatë muajve të dimrit, ndërsa vlerat minimale në muajin korrik. Vlera mesatare për të gjithë vitin është 1299 mm. Numri i ditëve me shtresë reshjesh mbi 0.1 mm varion midis 85 dhe 100 ditëve. Në përgjithësi, reshjet maksimale nuk janë shiu i rrëmbyeshëm.

Rënia e dëborës është një fenomen i rrallë dhe një shtresë e rëndësishme dhe e qëndrueshme e dëborës nuk vërehet në këtë zonë. Shtresa maksimale e dëborës zakonisht arrin vlerën 5–10 cm dhe shumë rrallë 15–17 cm.

Table 2 Shpërndarja ndërvjetore e reshjeve (mm)

Months	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Year
Precipitations	151	121.5	126.5	110.4	92.9	65.2	46.2	57.9	80.8	110.6	138.1	158.7	1299




Figura 11 - Shpërndarja ndërvjetore e reshjeve (mm)

Mesatarisht në këtë zonë, ka një rritje të reshjeve vjetore prej rreth 110 mm për çdo 100 m lartësi. Numri i ditëve me reshje ≥ 1.0 mm varion nga 1.6 ditë në korrik deri në 9.1 ditë në nëntor. Gjatë një viti, ka mesatarisht 76.9 ditë me reshje ≥ 1.0 mm

5 PROPOZIMI I PROJEKTIT

5.1 Objektivat e Studimit

Qellimi i këtij projekti është të marrë në shqyrtim dhe të shpjegojë procesin e projektimit për shtimin e zonave rekreative në shërbim të turizmit detar.

Bazuar në kërkesat e projektit, lindi nevoja e projektimit infrastrukturor të zgjerimit të pedonales kryesore përgjatë vijës së bregdetit sipas masterplanit të konceptuar nga arkitektet, u projektuan rrugicë që gjarpërojnë midis zonave rekreative, u projektuan platforma me funksione të ndryshme në shërbim të turizmit detar, pushuesve dhe vizitorëve si shërbime bar-kafe, anfiteater, palester e hapur, shërbime mjekësore tualete etj.

Sipas Masterplanit, për të plotësuar kërkesat e komunitetit dhe vizitorëve, projekti përfshin një gamë të gjerë hapësirash rekreative dhe shërbimesh publike, si:

- Kinema në natyrë dhe anfiteatër të hapur për evente kulturore.
- Qendra mjekësore dhe ambiente ndihmëse për sigurinë dhe shëndetin e vizitorëve.
- Fusha sportive për tenis, volejboll plazhi, futboll, si dhe palestra në ambient të hapur.
- Hapësira për fëmijë si kënde lojërash, parqe argëtimi dhe skate park.
- Qendra për turistët dhe ambiente për ndryshim rrobash e dush publik.
- Pavilonet (struktura metalike 4 m të larta)

Pavilonet ndahen sipas madhësisë dhe funksionit:

- XS (30m²): Hapësira të vogla shërbimi si: hapësira komerciale, hapësira pushimi, zone qëndrimi për rojtaret e plazheve, tualete, parkim bicikletash etj.
- S (60 m²): Hapësira po ashtu të vogla ku përfshihen: hapësira për piknik, stenda komerciale, podium i jashtëm, dhoma ndërimi, dhoma falje etj.
- M (140 m²): Hapësira deri në 140 m² ku përfshihen: klube plazhi, zona me kamionë ushqimi, kinema të hapura ose platforma për joga.
- L (300 m²): Hapësira deri në 300m² ku përfshihen: Bare plazhi, anfiteatër ose qendra turistike me shërbime informuese.
- XL (500+ m²): Hapësira 500 m² ose më shumë ku përfshihen: Qendra sportive, palestra të hapura, fusha sportive apo hapësira të mëdha eventesh etj.

Pavijonet janë konceptuar si struktura të hapura dhe transparente që shërbejnë si ndërmjetës midis hapësirës publike dhe natyrës, duke ofruar mbrojtje nga dielli dhe moti pa e kufizuar ndjesinë e hapësirës së lirë. Forma e tyre organike ndjek linjat natyrore të terrenit, ndërsa horizonti i çatisë krijon një dialog të qetë me vijën bregdetare dhe peizazhin përreth. Përmes përmasave të kontrolluara dhe elementeve të lehta konstruktive, pavijonet ofrojnë një ndjenjë fluiditeti dhe përshkueshmërie vizuale.

Me realizimin e këtij projekti është e sigurt se:

- Do të rritet vlera e aseteve në zonë,
- Krahas ekspertizës me të mirët, do të rriten furnizimet dhe shërbimet në zonën e projektit dhe si rezultat do të përmirësohet cilësia e jetesës në këtë komunitet,
- Do të sjellë përmirësimin e standardeve të punimeve për të krijuar një kulturë të qëndrueshme të menaxhimit të mjedisit, mbrojtjes së shëndetit në punë, kryerjen e proceseve të punës në përputhje me kërkesat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së pronës.

5.1.1 Lista e zonave te projektuara

Proekti inxhinierik eshte realizuar ne koordinim te plote me projektin arkitektonik. Zonat nga 1 deri ne 6 jane trajtuar me vete por masterplani i pergjithshem do te funksionoj si nje i vetem . Projekti i infrastruktures permban :

1. Zgjerimin e pedonales kryesore (shih vizatimet)
2. Ndertimi i rrugivave gjarperushe te cilat pershkojne zonat rekreative duke krijuar akses te lehte
3. Ndetimi i platformave te hapura ose me mbulesa me konstruksion metalik per funksione te ndryshme sipas parashikimeve ne masterplan
4. Rrjeti i ri i KUZ per te gjitha zonat ku do te kete sherbime
5. Rrjeti i ri i Furnizimit me uje per te gjitha zonat ku do te kete sherbime
6. Rrjeti I parashikuar per vaditje
7. Projekti i rrjeteve dhe ndricimit sipas masterplanit
8. Projekti strukturor i platformave me strukture metalike sipas masterplanit

5.1.2 Seksioni tip

Ne varesi te funksionalitetit si dhe parashikimeve te arkitektures te elementeve eshte bere projektimi i shtresave . Shtresat e perdorura per sazhet dhe per zgjerimin e pedonales jane shtresa betoni me siperfaqe beton te lare. Soleta e betonit pergjithesisht eshte perdorur 10 cm me nje zgare fi 8, zgjidhje konstruktive duke qene se ne zone nuk do te kalojne ose do te kalojne vetem mjetet e sherbimit por per shkak se gjeologjia dhe terreni eshte rere dhe ka prani uji. Per kete arsyse poshte soletes se betonit jane perdorur shtresa stabilizanti dhe cakell me gjeotekstil per te rritur qendrueshmerine dhe per te ndaluar perzjerjen e materialeve . Platformat do te jene me baze strukturore betoni, dhe siperfaqet jane pershtatur ne baze te funksionalitetit te platformave.




Figura 12 – Seksionet terthore tip i shtresave

5.1.3 Kanalizimi I Ujrave zeza

Kanalizimet e ujrave të zeza janë propozuar që shkarkimi i tyre do të behët pranë linjave ekzistuese, të cilat janë konsideruar në anën tjetër të pedonale kryesore, në zonën e banuar. Për secilin element që kërkon sistem KUZ është parashikuar një pusëtë e cila do të shkarkojë në sistemin ekzistues me të afert.




Figura 13 – Plan KUZ




Figura 14 – Puseta tip per lidhjet e Ujrave të Zeza.

5.1.4 Ujesjellesi dhe rrjeti i vaditjes

Gjithashtu për furnizimin me ujë është azhurnuar rrjeti sipas dokumentave të marra dhe është vënë re se linjat ekzistojnë në zonë. Projekti ynë propozon dalje të linjave për furnizim me ujë dhe për sistemin e vaditjes nga rrjeti ekzistues si në vizatimet bashkëngjitur.

Rrjeti i FU dhe vaditjes është propozuar të lidhet me linjat ekzistuese, të cilat janë konsideruar në anën tjetër të pedonale kryesore, në zonën e banuar. Për secilin element që kërkon sistem FU është parashikuar një pusëtë e cila do të lidhet me sistemin e furnizimit me të afërt. Gjithashtu për zonat e gjelbëruara janë lënë dalje me pusëtë për të mundësuar vaditjen.




Figura 15 – Plani FU dhe vaditja




Figura 16 – Puseta tip per ujesjellsin

6 PROJEKTI ELEKTRIK

6.1 Përshkrimi i objektit

Qëllimi i projektit elektrik është të sigurojë furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike për të gjitha platformat dhe hapësirat publike të parashikuara në zonën bregdetare, duke përfshirë pedonalen kryesore dhe pasazhet që lidhen me të. Ky projekt synon të krijojë një sistem ndriçimi funksional dhe tërheqës estetikisht, duke mbështetur aktivitetet turistike, rekreative dhe komerciale në mënyrë të sigurt dhe efikase. Ndriçimi i planifikuar do të përmirësojë orientimin, sigurinë dhe komoditetin e vizitorëve, duke kontribuar gjithashtu në estetikën dhe ambientimin e përgjithshëm të bregdetit.

6.2 Rregullat dhe standartet

Hartimi i Projektit elektrik bazohet në standartet dhe normat në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Norma dhe standarte të njohura dhe të aprovuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS).

Objekti kategorizohet si ndriçim i infrastrukturës rrugore dhe si i tillë do të trajtohet në këtë projekt.

Instalimet duhet të bëhen në mënyrë strikte siç kërkohen nga normat SSH në fuqi. Karakteristikat e impianteve dhe komponentëve të tyre duhet të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Instalimet duhet të përmbushin kërkesat e OSHEE.

Standarte dhe Norma Teknike

SSH HD 60364-7-718:2013 :Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 7-718: Kërkesat për instalimet ose vendndodhjet speciale - Mjetet e nevojshme dhe vendet e punës

SSH HD 60364-7-718:2013/A11:2017 : Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 7-718: Kërkesa për instalimet ose vendndodhjet speciale - Objektet komunale dhe vendet e punës

SSH HD 60364-1:2008: Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 1: Parimet bazë, vlerësimi i karakteristikave të përgjithshme, përcaktimet

SSH HD 60364-4-41:2007: Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-41: Mbrojtja për garantimin e sigurisë - Mbrojtja kundër goditjeve elektrike

SSH HD 60364-4-42:2011/A1:2015 : Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-42: Mbrojtja për garantimin e sigurisë - Mbrojtja kundër efekteve termale

SSH HD 60364-4-43:2010: Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-43: Mbrojtja për sigurinë - Mbrojtja kundër mbirrymave

SSH HD 60364-4-442:2012: Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-442: Mbrojtja për garantimin e sigurisë - Mbrojtja e instalimeve të tensionit të ulët kundër mbitensionit të përkohshëm për shkak të defekteve të tokëzimit në sistemin e tensionit të lartë dhe defekteve në sistemin e tensionit të ulët

SSH HD 60364-4-443:2016: Instalime elektrike të ndërtesave - Pjesa 4-44: Mbrojtja për garantimin e sigurisë. Mbrojtja kundër çrregullimeve të tensionit dhe çrregullimeve elektromagnetike - Klauzola 443: Mbrojtja kundër mbitensionit me origjinë atmosferike ose për shkak të manovrimit.

SSH HD 60364-4-444:2010/AC:2012: Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-444: Mbrojtja për sigurinë - Mbrojtja kundër çrregullimeve të tensionit dhe çrregullimeve elektromagnetike

SSH HD 60364-5-51:2009/A11:2013: Instalimet elektrike të ndërtesave - Pjesa 5-51: Përzgjedhja dhe ngritja e pajisjeve elektrike - Rregulla të zakonshme

SSH HD 60364-5-51:2009: Instalimet elektrike të ndërtesave - Pjesa 5-51: Përzgjedhja dhe ngritja e pajisjeve elektrike - Rregulla të zakonshme

- SSH HD 60364-5-52:2011: Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-52: Përzgjedhja dhe montimi i pajisjeve elektrike - Sistemet e instalimeve elektrike
- SSH HD 60364-5-53:2015: Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-53: Përzgjedhja dhe ndërtimi i pajisjes elektrike - Pajisjet e shpërndarjes dhe kontrollit
- SSH HD 60364-5-534:2016: Instalime elektrike të ndërtesave - Pjesa 5-53: Përzgjedhja dhe montimi i pajisjeve elektrike - Izolimi, çkyçja dhe kontrolli - Klauzola 534: Pajisje për mbrojtjen ndaj mbitensionit të përkohshëm
- SSH HD 60364-5-54:2011: Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-54: Përzgjedhja dhe ngritja e pajisjeve elektrike - Sistemit i tokëzimit dhe përcjellësit mbrojtës
- SSH HD 60364-5-551:2010/A11:2016: Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-55: Përzgjedhja dhe montimi i pajisjeve elektrike - Pajisje të tjera - Klauzola 551: Pajisjet gjeneruese të tensionit të ulët
- SSH HD 60364-5-557:2013/A11:2016: Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-557: Përzgjedhja dhe ndërtimi i pajisjeve elektrike - Qarqet ndihmëse
- SSH HD 60364-5-559:2012: Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-559: Përzgjedhja dhe ngritja e pajisjeve elektrike - Ndriçuesit dhe instalimet e ndriçimit
- SSH HD 60364-5-56:2010/A11:2013: Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-56: Përzgjedhja dhe ngritja e pajisjeve elektrike - Shërbimet e sigurisë
- SSH HD 60364-6:2016/A11:2017: Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 6: Verifikimi
- SSH HD 60364-7-701:2007/A11:2011 : Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 7-701: Kërkesa për instalime ose vende të veçanta - Vende që kanë dush ose vaskë
- SSH HD 60364-7-701:2007/AC:2011: Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 7-701: Kërkesat për instalimet ose vendndodhjet speciale - Vendosja në vende që kanë dush ose vaskë
- SSH HD 60364-7-702:2010: Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 7-702: Kërkesa për instalime ose vendndodhje të veçanta - Pishina dhe shatërvanë
- SSH HD 60364-7-703:2005: Instalime elektrike të godinave - Pjesa 7-703: Kërkesa për instalime ose vende të veçanta - Dhoma dhe kabina ngrohës saunë
- SSH HD 60364-7-704:2007: Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 7-704: Kërkesa për instalime ose vende të veçanta - Instalimet e kantierëve të ndërtimit dhe të shkatërrimit
- SSH HD 60364-7-705:2007/A11:2012: Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 7-705: Kërkesa për instalime ose vende të veçanta - Stabilimentet agrikultural dhe hortikultural
- SSH HD 60364-8-1:2015 :Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 8-1: Eficenca e energjisë
- SSH IEC 60364-4-41:2005+A1:2017: Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-41: Mbrojtja për garantimin e sigurisë - Mbrojtja ndaj goditjes elektrike
- SSH IEC 60364-4-44:2007+A1:2015: Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-44: Mbrojtja për siguri - Mbrojtja ndaj çrregullimeve të tensionit dhe çrregullimeve elektromagnetike
- SSH IEC 60364-5-53:2001/A2:2015: Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-53: Përzgjedhja dhe ndërtimi i pajisjes elektrike - Pajisjet e shpërndarjes dhe kontrollit
- SSH IEC 60364-6:2006: Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 6: Verifikimi
- SSH IEC 60364-7-714:2011: Instalime elektrike të ndërtesave - Pjesa 7-714: Kërkesat për instalimet ose vendndodhjet speciale - Instalimet e ndriçimit të jashtëm
- DS IEC/TR 60909-1:2009: Rrymat e lidhjeve të shkurtra në sistemet trefazore a.c. - Pjesa 1: Faktorët për llogaritjen e rrymave të lidhjes të shkurtër në përputhje me IEC 60909-0
- DS IEC/TR 60909-2:2009: Rrymat e lidhjeve të shkurtra në sistemet trefazore a.c. - Pjesa 2: Të dhënat e pajisjeve elektrike për llogaritjet e rrymës të lidhjes të shkurtër
- SSH EN 60909-0:2001: Rrymat e qarkut të shkurtër - në sistemet e rrymës alternative trifazore - Pjesa 0: Llogaritja e rrymave

SSH EN 60947-1:2007/A1:2011: Pajisjet shpërndarëse dhe të kontrollit të tensionit të ulët - Pjesa 1: Rregullat e përgjithshme

SSH EN 60947-1:2007/A2:2014: Pajisjet shpërndarëse dhe të kontrollit të tensionit të ulët - Pjesa 1: Rregullat e përgjithshme

SSH EN 60947-2:2006/A1:2009: Pajisje shpërndarëse dhe kontrolli për tension të ulët - Pjesa 2: Ndërprerësit e qarkut

SSH EN 60947-2:2006/A2:2013: Pajisje shpërndarëse dhe kontrolli për tension të ulët - Pjesa 2: Ndërprerësit e qarkut

SSH EN 61936-1:2010/A1:2014: Instalimet e fuqisë që tejkalojnë 1 kV a.c. - Pjesa 1: Rregulla të zakonshme

SSH EN 60076-1:2011: Transformatorët e fuqisë - Pjesa 1: Të përgjithshme

SSH EN 60076-11:2004: Transformatorët e fuqisë - Pjesa 11: Transformatorët e tipit të thatë

SSH EN 60076-5:2006: Transformatorët e fuqisë - Pjesa 5: Aftësia për t'i qëndruar qarkut të shkurtër

SSH IEC 60076-12:2009: Transformatorët e fuqisë - Pjesa 12: Udhëzues ngarkimi për transformatorët e fuqisë të tipit të thatë

SSH IEC 60076-8:1997: Transformatorët e fuqisë - Pjesa 8: Udhëzues për zbatim

SSH IEC 60947-2:2016: Pajisje shpërndarëse dhe kontrolli të tensionit të ulët - Pjesa 2: Ndërprerësit e qarkut

SSH EN 62305-1:2011/AC:2016-11:2016: Mbrojtja kundër rrufeve - Pjesa 1: Parime të përgjithshme

SSH EN 62305-2:2012: Mbrojtja kundër rrufeve - Pjesa 2: Menaxhimi i rrezikut

SSH EN 62305-3:2011: Mbrojtja kundër rrufeve - Pjesa 3: Dëmtimi fizik në struktura dhe rreziku i jetës

SSH EN 62305-4:2011/AC:2016-11:2016: Mbrojtja kundër rrufeve - Pjesa 4: Sistemet elektrike dhe elektronike brenda strukturave

SSH EN 60228:2005/AC:2005: Konduktorët e kablllove të izoluar

6.3 Ndricimi I Jashtem

6.3.1 Përcaktimi i llojit të rrugës

Për të llogaritur ndricimin e pedonale dhe pasazheve janë ndjekur normat europiane më të fundit përsa i përket llogaritjeve të fluksit dhe uniformitetit të ndriçimit rrugor. Norma mbi të cilën janë kryer këto llogaritje është EN 13201:2015.

Norma EN 13201:2015 është një standard europian që përcakton metodat për vlerësimin e ndriçimit rrugor dhe rrugëve. Kjo normë përfshin kërkesa për projektimin e ndriçimit rrugor dhe përshkruan si duhet të jetë vlerësimi i këtij ndriçimi në terma të nivelit të ndriçimit dhe uniformitetit të ndriçimit në rrugë. Gjithashtu, ajo specifikon nivelet minimale të ndriçimit dhe cilësitë e ndriçimit për kategoritë e ndryshme të rrugëve dhe mjediseve të tjera të hapura.

Përmbajtja e kësaj norme përfshin të dhëna teknike të lidhura me karakteristikat e ndriçimit të nevojshme për sigurinë dhe efikasitetin e rrugëve, duke mbuluar aspekte si fuqia e dritës, uniformiteti i ndriçimit, dhe efektet e dritës së dëmtimit.

Kjo normë është e rëndësishme për projektuesit dhe inxhinierët që merren me projektimin e infrastrukturës rrugore, pasi që ka për qëllim sigurinë dhe përmirësimin e kushteve të udhëtimit nëpër rrugë.

Në standardin EN 13201-2:2015, klasat e ndriçimit (M, C, P, HS, SC, EV) përcaktohen nën grupet e tyre të ndryshme për të adresuar nevojat e ndryshme të ndriçimit në rrugë dhe zona të tjera rrugore. Këto nentipe për secilin grup janë si vijon:

- Klasa M (Motorized Traffic Routes):

Klasa M përfshin nentipet për vozitësit e makinave në rrugë kryesore dhe të shpejtësi të mesme deri të larta. Nentipet specifike përfshijnë:

Luminancën mesatare e sipërfaqes së rrugës.

Uniformitetin total të ndriçimit.

Uniformitetin longitudinal të ndriçimit për kushte të thata.

Kriteret për shndritjen e dëmtueshme (TI - Threshold Increment).

Rrjetën e ndriçimit në zonat përreth (EIR - Edge Illuminance Ratio).

Uniformitetin total të luminancës në kushte të lagësht.

- Klasa C (Conflict Areas):

Klasa C është për vozitësit e makinave në zona konfliktuale si rrugë tregtare, kryqëzime komplekse, rrethore dhe zona të pritjes. Nentipet specifike përfshijnë:

Illuminancën horizontale mesatare e sipërfaqes së rrugës.

Uniformitetin total të ndriçimit.

- Klasa P (Pedestrians and Cyclists):

Nentipet: Klasa P është për këmbësorët dhe pedalistët në trotuare, pista bicikletash dhe zona të tjera rrugore. Nentipet specifike përfshijnë:

Illuminancën horizontale mesatare e sipërfaqes së rrugës.

Illuminancën minimale të ndriçimit.

- Klasa HS (Pedestrians and Cyclists - Hemispherical Illuminance):

Nentipet: Klasa HS është për këmbësorët dhe pedalistët në trotuare, pista bicikletash dhe zona të tjera rrugore. Nentipet specifike përfshijnë:

Illuminancën hemisferike mesatare e sipërfaqes së rrugës.

Uniformitetin total të kësaj illuminance hemisferike.

- Klasa SC (Security - Identification of Persons and Objects):

Nentipet: Klasa SC është për zona ku ndriçimi publik është i nevojshëm për identifikimin e personave dhe objekteve.

Bazohet në illuminancën e ndryshkut të gjysmecilindrik.

- Klasa EV (Vertical Surfaces):

Nentipet: Klasa EV është për zona ku nevojiten ndriçim të murit të kryqëzimit (p.sh., stacione të tarifave, zona të shkëmbimit).

Bazohet në illuminancën në planin vertikal të ndriçimit.

Këto nentipe specifike të secilës klase përcaktojnë kriteret dhe standardet për ndriçimin në bazë të nevojave të ndryshme të përdoruesve të rrugëve dhe tipit të zonës rrugore. Cilësitë dhe karakteristikat e ndriçimit janë të përshtatura për të siguruar sigurinë dhe efikasitetin e lëvizjes për secilën kategori dhe nentip të përcaktuar.


6.3.2 Llogaritjet e ndriçimit elektrik

Për rrjetin e tubacioneve të ndriçimit rrugor është parashikuar të instalohet një trasë me tuba plastikë me dy shtresorë për shtrirje nën bazën e trotuarit, me diametër $D=63\text{mm}$. Pusetat shpërndarëse të kësaj traseje do të jenë prej plastike, me kapakë $30\times 30\times 30\text{ cm}$. Gjatë montimit të tyre duhet të respektohen kushtet teknike të

detajuaara në specifikacionet teknike. Lidhja midis linjës kryesore dhe secilës shtylle duhet të bëhet përmes morsetës të vendosur në shtyllë. Duke pasur parasysh diametrat e zgjedhur të kablllove, dimensionimi i tubit do të jetë $D=63$ mm për linjën kryesore dhe $D=40$ mm për degezimin nga kutitë shpërndarëse deri tek shtyllat e ndriçimit. Komandimi i ndezjes së ndriçimit do realizohet nëpërmjet releve krepuskolare. Në shesh ka dhe ndriçues spote dhe dekorativ të cilët janë paraqitur në specifikime teknike dhe në projekt.

7 PROJEKTI KONSTRUKTIV

Përgjatë bregdetit në studim të Durrësit do të ndertohen disa platforma të ngritura me përmasa të ndryshme, nga madhësia XS deri në L. Ato mbështeten mbi plinta të lidhura me trarë betoni, ndërsa janë përforcuar me profile metalike për të garantuar qëndrueshmëri më të lartë. Mbi platforma është ndërtuar struktura me profile metalike, e projektuar dhe llogaritur sipas standardeve të Eurokodeve.



7.1 Kerkesat Sipas Eurocodeve

Eurokodi EN 1998 është i lidhur drejtpërdrejt me të gjitha Eurokodet që kanë të bëjnë me materialet dhe gjithashtu me Bazat e Projektimit Struktural, pra Eurokodi EN 1990. Për sa kohë që efektet e veprimit sizmik varen nga masat (peshat) e shpërndara mbi strukturë, EN 1998 është i lidhur indirekt me EN 1991.




Figura 4 – Lidhja midis Eurokod8, pjesa e 1 me euordokodet e tjera.

Standardi EN 1990 përcakton Parimet dhe kërkesat për sigurinë, shërbyeshmërinë dhe qëndrueshmërinë e strukturave, përshkruan bazën për projektimin dhe verifikimin e tyre dhe jep udhëzime për aspekte të lidhura me besueshmërinë strukturore.

EN 1990 është menduar të përdoret së bashku me EN 1991 deri në EN 1999 për projektimin strukturor të ndërtesave dhe punimeve të inxhinierisë civile, duke përfshirë aspektet gjeoteknike, projektimin strukturor në rast zjarri, situatat që përfshijnë tërmete, ekzekutimin dhe strukturat e përkohshme.

EN 1990 është i zbatueshëm për projektimin e strukturave ku përfshihen materiale të tjera ose veprime të tjera jashtë fushëveprimit të EN 1991 deri në EN 1999. EN 1990 është i zbatueshëm për vlerësimin strukturor të ndërtimeve ekzistuese, në zhvillimin e projektimit të riparimeve dhe ndryshimeve ose në vlerësimin e ndryshimeve të përdorimit.

7.2 Jetëgjatësia e projektuar e veprës

Jeta e projektuar e punës është periudha e supozuar për të cilën një strukturë do të përdoret për qëllimin e saj të synuar me mirëmbajtje të parashikuar, por pa qenë të nevojshme riparime të mëdha. Jetëgjatësia e projektuar e punës duhet të specifikohet, pasi është e nevojshme për përcaktimin e veprimeve të projektimit (p.sh. tërmeti), vetitë e materialeve (p.sh. lodhja), për zhvillimin e strategjive të mirëmbajtjes.

Design working life	Indicative design working life (years)	Shembuj
1	10	Struktura provizore
2	10 to 25	Pjesë strukturore të zëvendësueshme, p.sh. trarë portalesh, kushineta
3	15 to 30	Struktura për qëllime agrikulture dhe të ngjashme
4	50	Godina civile dhe të zakonshme
5	100	Building structures and other common structures

Figura 17 – Lidhja midis Eurokod8, pjesa e 1 me euordokodet e tjera.

Jeta e supozuar e punës së projektimit në EN 1990 për strukturat e ndërtesave dhe strukturat e tjera të zakonshme është $TL = 50$ vjet. Vlera të ndryshme mund të merren në konsideratë përmes faktorit të rëndësisë së strukturës (diferencimi i besueshmërisë).

Llogaritje te detajuara jepen ne Raportin Strukturalor.

7.3 Projektim Strukturalor I Objekteve

Objekti është një kat dhe është menduar me kollona dhe trarë të fshehur. Me strukture celiku dhe me mbules qe do jete me flete celiku. Traret kryesoret qe lidhet me kollonat jane menduar 20x200 ndersa rigelat sekondare, jane me dimensione 100x10. Celiku qe do perdoret ne keto struktura eshte propozuar S275.




Figura 18 – Modelit strukturor 3D




Figura 19 – Themelet dhe kolona

Themelet jane projektuar si plinta 1x1x06 m dhe trare lidhes 06x04 m.

Llogaritje te detajuara jepen ne Raportin Strukturor.

**NDËRHJRJE PËR RRITJEN E OFERTËS TURISTIKE DHE PËR
PËRMIRËSIMIN FUNKSIONAL DHE ESTETIK TË BREGDETIT**

VENDNDODHJA : DURREËS, SHQIPERI

RAPORTI TOPOGRAFIK

Permbajtja

1	STUDIMI TOPOGRAFIK	3
1.1	Hyrje.....	3
1.2	Azhornimi Topografik	4
1.3	Pikat e reja te poligonit.....	4
1.4	Mjetet Topografike	5
1.5	Harta Topografike.....	10

1 STUDIMI TOPOGRAFIK

1.1 Hyrje

Zona qe do te rilevohet ndodhet ne qytetin e Durrësit, përfshin zonen nga porti i Durrësit deri tek Kavalishenca.

Ky projekt ka për qëllim të transformojë zonën bregdetare të qytetit të Durrësit në një destinacion bashkëkohor turistik, rekreativ dhe urban, përmes ndërhyrjeve arkitekturore dhe urbane të planifikuara me kujdes. Ai përfshin zgjerimin e plazhit ekzistues, krijimin e një parku linear të gjelbër përgjatë vijës bregdetare, zhvillimin e hapësirave publike shumëfunktionale dhe integrimin e infrastrukturave të reja rekreative dhe sportive. Gjatësia e zonës së ndërhyrjes është rreth 2.8 km, me një zgjerim të vijës bregdetare deri në 100 metra drejt detit, duke krijuar hapësira të reja publike për banorët dhe vizitorë.

Zona shtrihet ndërmjet koordinatave gjeografike:

- PIKA A : N = 4574970.10m E = 371759.92m
- PIKA B : N = 4574821.04m E = 371684.10m
- PIKA C : N = 4572905.81m E = 374166.22m
- PIKA D : N = 4573024.48m E = 374327.76m



1.2 Azhornimi Topografik

Punimet topografike per projektin ne fjale u kryen mbi bazen e kerkesave teknike te pergjithshme dhe specifike te parashikuara nga Klienti

Para fillimit te punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme hartografike, gjeodezike si dhe paisjet perkatese. I gjithe procesi i rilevimit konsiston ne krijimin e nje harte digjitale si baze per projektin e infrastruktures. E gjithë puna filloi me rikunjicionin e terrenit dhe ndertimin e poligonit te shperndare ne menyre te rregullt ne zonen e interesit (te cilet do te perdoren dhe gjate ndertimit te vepres). Bazamenti gjeodezik ka sistemin koordinativ UTM 34N .

Punet topografike per ndertimin e kesaj harte konsistojne ne hapat e meposhtme:

- Ndertimi i Poligonit, Nivelacioni & Matja e tyre me GPS.
- Rilevimi i detajuar.
- Perpunimi i te dhenave dhe hartimi i hartes digjitale.

1.3 Pikat e reja te poligonit

Per ndertimin e poligonit jane bere matje me GPS duke perdorur "Marres GPS me dopio frekuence", me metoden statike, duke bere matje me interval kohor cdo 1" dhe marrje te dhenash 20 minuta. Ne njerren prej pikave te u vendos njeri nga marresat gps i cili morri te dhena te vazhduara per rreth 1 ore dhe pikat e tjera u maten me dy marresat e tjere gps CHC i93 , te cilet kryen matjet 20 minuteshe ne secilen prej pikave te reja te poligonit. Per tu referuar me sistemin e kerkuar nga detyra e projektimit, UTM 34 N, u siguruan te dhena nga sistemi Cors. Matjet statike dhe kinematike, u perdoren per te mbeshtetur rjetin e ri te pikave.

Per te kryer rilevimin topografik u perdoren pajisje GPS RTK të cilat komunikojnë me radio si dhe me GPRS internet. Seti i pajisjeve të përdorura për të realizuar punimet përfshin tre antena CHC GPS, një transmetues radio dhe tre tastiera akumulues të të dhënave CHC i93. Metodatat standarde GPS RTK u përdorën në përcaktimin e vendndodhjeve. Procedurat për metodën standarde përfshijnë:

- U zgjodh sistemi UTM 34 N dhe nëpërmjet lidhjes me radio u realizuan matjet e detajuara te reja.
- Një prej antenave GPS u konfigurua si një njësi "stacion bazë" dhe u centrua mbi pikën e kontrollit të njohur. Antena GPS u pozicionua në mënyrë që të jetë e fiksuar dhe në nivel, në një pozicion të qëndrueshëm mbi pikën e kontrollit.
- Antena e dytë dhe e tretë e GPS u konfiguruan si njësi marrëse "rover" dhe u vendosën në zhalonat përkatës prej 2 metrash me bashkuesin e tastierës.
- Një kontroll i dytë është realizuar në pikën më të afërt të fiksuar në terren gjatë ditëve vijuese të rilevimit.

Marrësi Gps funksionon në modalitetin Kinematik në kohë reale, ku merren korrigjimet nga stacioni bazë në të njëjtën kohë që matet. Ky sistem, korrigjon stacionin e marrësit, duke lejuar që pikat të regjistrohen në tastierë në nivelet e saktësisë nën-centimetër, përmes një lidhjeje të brendshme radio. Niveli i saktësisë u arrit duke përdorur marrësa kinematic DGPS në kohë reale; të kufizuar për të marrë lexime brenda niveleve të saktësisë 20 mm.

Grupi ishte i përbërë nga kater inxhinierë topograf, të cilët së pari vendosën pikat e poligonit në vend, më pas proceduan me matjet e detajuara duke përdorur GPS në metodën RTK ‘Real Time Kinematic’ si dhe Stacioni Total ne zona ku nuk ishte e mundur të matet me GPS për shkak të mungesës së sinjalit.

1.4 Mjetet Topografike



Instrumentët e përdorur janë CHC i93 GPS, Total Station LeicaIconBuilder 503 5”.

Specifikimet teknike të këtyre instrumentëve janë si më poshtë:

Çertifikime:

IEC 60950-1 (Electrical Safety); FCC OET Bulletin 65 (RF Exposure Safety); FCC Part 15.105 (Class B), Part 15.247, Part 90; PTCRB (AT&T); Bluetooth SIG; IC ES-003 (Class B); Radio Equipment Directive 2014/53/EU, RoHS, EEEE; Australia & Neë Zealand RCM; Japan Radio and Telecom MIC

SPECIFIKIME PER PERFORMANCEN

Matjet

- Çip I avancuar “Survey GNSS” me 440 kanale
- Kapja e sinjalit satelitor ne te njejten kohe:
 - GPS: L1C/A, L1C, L2C, L2E, L5
 - GLONASS: L1C/A, L1P, L2C/A, L2P, L3
 - SBAS: L1C/A, L5 (for SBAS satellites that support L5)
 - Galileo: E1, E5A, E5B
 - BeiDou (COMPASS): B1, B2
- SBAS: QZSS, E5AAS, EGNOS, GAGAN
- Positioning rates: 1 Hz, 2 Hz, 5 Hz, 10 Hz, and 20 Hz

Performanca ne Pozicionim²

Code differential GNSS positioning

Horizontal. 0.25 m + 1 ppm RMS

Vertikal. 0.50 m + 1 ppm RMS

SBAS differential positioning accuracy³. typically <5 m 3DRMS

Matje me metoden Statike GNSS

Saktesi e larte STATIKE

Horizontal. 3 mm + 0.1 ppm RMS

Vertikal. 3.5 mm + 0.4 ppm RMS

Static and Fast Static

Horizontal. 3 mm + 0.5 ppm RMS

Vertikal. 5 mm + 0.5 ppm RMS

Matje me metoden Kinematike (PPK) GNSS

Horizontal. 8 mm + 1 ppm RMS

Vertikal. 15 mm + 1 ppm RMS

Matje me metoden RTK (Real Time Kinematic)

Brinje ne gjatesi <30 km

Horizontal. 8 mm + 1 ppm RMS

Vertikal. 15 mm + 1 ppm RMS

Netëork RTK⁴

Horizontal. 8 mm + 0.5 ppm RMS

Vertikal. 15 mm + 0.5 ppm RMS

Koha e inicializimit. typically <8 seconds

Besueshmeria ne matje⁵. typically >99.9%

Stacion Total Leica Builder 503 5"



Fleksibiliteti qe ka rendesi

Te gjitha te dhenat jane te mbrojtura nga Leica Geosystems AG, Heerbrugg, Sëitserland, 2009. 768716en – XII.09 – RDV

Angle Measurement (Hz, V)

Saktesia (Standard deviation ISO-17123-3) 3" (1 mgon),

Metoda Absolute, e vazhduar, diametrical

Rezolucioni i ekranit 0.1" / 0.1 mgon / 0.01 mil

Kompensimi Quadruple axis compensation (Setting On, Off)

Saktesia e kompensimit 0.5", 1", 1.5"

Distance Measurement ëith Reflector

Distanca me prizem te madh GPR1 3'500 m

Distanca ne sipërfaqe reflektive (60 mm x 60 mm) 250 m

Saktesia /Koha e matjes

(Standard deviation ISO-17123-4)

Standard: 1.5 mm+2 ppm / typ. 2.4 s, Fast: 3 mm+2 ppm / typ. 0.8 s, Tracking: 3 mm+2 ppm / typ. <0.15 s

Distance Measurement ëithout Reflector

Distanca (90% reflective)

FlexPoint

PinPoint – Poëer

PinPoint – Ultra > 1000 m3)

Saktesia / Koha e matjes

(Devijimi standard ISO-17123-4)

2 mm+2 ppm2 / typ. 3 s

Madhesia e pikes se lazerit At 30 m: approx. 7 mm x 10 mm, At 50 m: approx. 8 mm x 20 mm

Data storage / Communication

Memoria e brendeshme Max.: 100'000 fixpoints, Max.: 60'000 measurements

Memoria e jashtme USB 1 Gigabyte, Transfer time 1'000 points/second optional

Nderlidhjet : Serial (Baudrate 1'200 to 115'200)

USB Type A and mini B, *Bluetooth®* Ēireless optional

Formate komunikimi GSI / DXF / LandXML / CSV / user definable ASCII formats

General

Zmadhimi 30 x

Fusha e shikimit 1° 30' (1.66 gon) / 2.7 m at 100 m

Fokusimi 1.7 m to infinity

Ngjyrat dhe ndricimi, 5 nivele ndricimi

Keyboard and Display

Tastiera Alpha-numerike

Opsionale me tinguj zanorl

Operating System

Windows CE 5.0 Core

Laserplummet

Type Laser point, illuminated, 5 brightness levels

Centering accuracy 1.5 mm at 1.5 m Instrument height

Battery

Type Lithium-Ion

Operating time approx. 20 hours¹

Ēeight

Total station including GEB211 and tribrach 5.1 kg

Environmental

Temperature range (operation) -20° C to +50° C (-4° F to +122° F)

Arctic Version -35° C to 50° C (-31° F to +122° F) optional

Dust & splash proof (IEC 60529) IP55

Humidity 95%, non condensing

FlexField Onboard Softēare

Application programs Topography (Orientation & Surveying), Stake Out, Resection, Height Transfer, Construction,

Area (Plan & Surface), DTM Volume calculation, Tie Distance (MLM), Remote Height, Hidden Point,

Backsight Check, Offset, Reference Line, Reference Arc, Reference Plane, COGO, Road 2D

Application programs Roadworks 3D, Traverse Pro optional

MAVIC 3 RTK Seria Mavic 3 ripercakton standardet e industrise per dronet e vegjel komerciale. Me nje mbyltese mekanike, nje kamere zmadhimi 56x dhe nje modul RTK per saktesi ne nivel centimetri, Mavic 3E sjell hartimin dhe efikasitetin e misionit ne lartesi te reja. Nje version termik eshte i disponueshem per shuarjen e zjarrit, kerkimin dhe shpetimin, inspektimin dhe operacionet e nates.	
VIDEO /SlidSHOW	
Karakteristikat kryesore -Kompakte dhe te rehatshme -4/3 CMOS Wide Camera -56x Hybrid Zoom -640 x 512 px Kamera termike -45-min koha e fluturimit -DJI O3 Transmetimi I ndermarrjes -Pozicionim ne nivel centimetrik me RTK - Altoparlant me volum te larte	Kompakte dhe e thjeshte E thjeshte dhe kompakte Seria Mavic 3 mund te mbahet ne njeren dore dhe te vendoset ne moment. E perkrer per pilota fillestare dhe veteran per te kryer misione te gjata. Dy modele ,aplikime te panumerta -DJI MAVIC 3E -DJI MAVIC 3T
	Performanca e Premium Kamera -Rilevim me shpejtesi -Performance e permirsuar ne drite te ulet -Fokusim dhe zbulon -Shikon te padukshmen -Zmadhim I njekohshem I ekranit te ndare

Efikasitet I jashtezakonshem operacional -Bateri te qendrueshme -Transmetim I imazhit te gjenerates se ardhshme - Sensi gjithedrejtues per fluturim te sigurt -Rruga e fluturimit	
	Aksesoret me te cilat pajiset: <u>1-DJI RC Pro Enterprise</u> <u>2- Moduli RTK</u> 3- Altoparlant <u>4- Stacioni celular D-RTK 2</u>

1.5 Harta Topografike

Azhornimi Topografik - Të gjithë elementët dhe detajet topografike janë të regjistruar me kode të veçantë në memorien e brendshme digjitale të instrumentave të përdorur nga Konsulenti.

Tek këto elemente përfshihen rrugët, bankinat, skarpatat, veprat e artit (urat, tombinat etj.), kryqëzimet, kanalet anësore, përrenjtë, lumenj, kanalet ujitës, puseta, mure mbajtës, pemët, ndërtesat, linja elektrike, linja telefonike, kryqëzime rrugësh etj., të cilat janë regjistruar me kodet përkatëse.

Mbas punës në terren është kryer përpunimi i të dhënave të matura me anën e programit Autodesk Civil3d. Pikat e rëlevuara janë hedhur në AutoCAD ku është bërë dhe lidhja e elementëve (bazuar tek kodet) e të gjithë zonës, duke krijuar një vizatim unik. Vizatimi është bërë në 3 dimensional, në mënyrë që mund të krijojmë modelin e terrenit në mënyrë digjitale. Janë paraqitur të gjitha detajet e relievit si rrugë, ura, tombino, përrenj, lumenj, mure, ndërtesa, rrethime, linja elektrike, etj. në shtresa të veçanta. Të gjitha stacionet janë paraqitur me shenjë konvencionale në vizatim.

Modeli digjital i terrenit është paraqitur ne file dwg si më poshtë:

1. Tre - dimensional (x,y,z), pika gjeodezike (Stacionet) në një shtresë të vetme.
2. Tre - dimensional (x,y,z) linjat e ndërprerjes së terrenit, si dhe elementë të tjerë topografik të terrenit në shtresat përkatëse.

Te dhenat e regjistruara ne software-in Trimble Access, analizohen, filtrohen dhe përpunohen per reduktimin e rilevimit te te dhënave ne kuoten e ellipsoidit WGS84.

Ne fakt, gjate rilevimit ne sistemin RTK te GPS, koordinatat e marra jane ato gjeografike ne kuoten e elipsoidit WGS84 te qendres se antenes Rover te vendosur ne varke; ne te njejten kohe echosounder regjistron thellesine e poshtme te tabanit ne te njejtin bosht te perbashket ne pozicionin planimetrik me antenen GPS.

Analiza e meteishme e te dhenave te regjistruara eshte kryer ne menyre qe te eliminohen te dhenat e gabuara (te dhenat qe vijne per gabime te ndryshme).

Procesimi final i perpunimit eshte kryer me software-in TBC dhe Autocad.

Dokumentet perfundimtare te dhena per klientin i referohen sistemit U.T.M. – zona 34N, me vizatimet e meposhtme:

- Harta Topografike e zones se interesit bazuar ne kuoten absolute (MSL), ne format AutoCAD,




Figura 1 – Harta Topografike e zones

**NDËRHJRJE PËR RRITJEN E OFERTËS TURISTIKE DHE PËR PËRMIRËSIMIN
FUNKSIONAL DHE ESTETIK TË BREGDETIT**

VENDNDODHJA : DURREËS, SHQIPERI

RAPORTI GJEOLGJIK DHE SIZMIK

Permbajtja

1	HYRJE.....	3
2	QËLLIMI I KËRKIMEVE GJEOTEKNIKE.....	4
3	PËRSHKRIMI I GJEOLGJISË NË ZONËN E STUDIMIT	5
4	TË DHENAT HIDROLOGJIKE TË ZONËS NË STUDIM.....	9
4.1	<i>Niveli i Ujerave Nentokesor</i>	<i>9</i>
5	INFORMACION MBI SIZMICITETIN E ZONËS	10
6	PËRSHKRIMI I STUDIMIT GJEOTEKNIK TË ZONËS	12
6.1	<i>Njesite Gjeoteknike.....</i>	<i>12</i>
6.2	<i>Procedurat e Operimit per Karakterizimin Gjeoteknik</i>	<i>12</i>
6.3	<i>Perfundime</i>	<i>16</i>

1 HYRJE

Ky projekt ka për qëllim të transformojë zonën bregdetare të qytetit të Durrësit në një destinacion bashkëkohor turistik, rekreativ dhe urban, përmes ndërhyrjeve arkitekturore dhe urbane të planifikuara me kujdes. Ai përfshin zgjerimin e plazhit ekzistues, krijimin e një parku linear të gjelbër përgjatë vijës bregdetare, zhvillimin e hapësirave publike shumëfunksionale dhe integrimin e infrastrukturave të reja rekreative dhe sportive. Gjatësia e zonës së ndërhyrjes është rreth 2.8 km, me një zgjerim të vijës bregdetare deri në 100 metra drejt detit, duke krijuar hapësira të reja publike për banorët dhe vizitorët.

Ky raport jep informacione mbi kushtet gjeologjike të zonës në studim.



Figure 1_Ortofoto e zones së projektit.

2 QËLLIMI I KËRKIMEVE GJEOTEKNIKE

Qellimi i ketj studimi eshte per studimin e e pergjithshem te zones per kete faze te projektimit. Jane marre ne shqyrtim materiale dhe studime te gjithe zones. Zona ne studim shtrihet nga porti i Duresit deri tek Kavalishenca.



Figure 2_Planimetria e projektit

3 PËRSHKRIMI I GJEOLLOJISË NË ZONËN E STUDIMIT

Depozitimet detare-lagunore jane depozitime nga prurjet e perrenjve dhe lumenjeve qe derdhen ne gjirin e Durrësit, perpunimi i tyre nga veprimtaria e detit dhe depozitimi prane vijes detare ne periudha te gjata gjeologjike duke formuar keshtu shtresa rerash, surerash ngjyre gri hiri, ne gjire te vecuara te bregdetit ka edhe depozitime argjilore lymore lagunore ngjyre gri, gjithashtu ne faza te ndryshme jane depozituar edhe materiale organike leshteriku ne forme gjurmesh, fragmente apo edhe ndershtresash me ngjyre gri te zeze. Depozitimet detare dhe lagunore ne pergjithesi jane pak deri mesatarisht te ngjeshura dhe jane gjithmone me lageshtire deri te ngopura me uje.

Në rajonin e Durrësit takohen depozitimet Neogjenike të Mesinianit dhe të Pliocenit (Seria Helmësi) dhe depozitimet Kuaternare.

Depozitimet e Mesinianit dalin kryesisht në veri-perëndim të qytetit të Durrësit dhe kanë dalje të drejtpërdrejtë në detin Adriatik. Pakot kryesore të këtyre depozitimeve janë:

N13m(c) - përfaqëson një pako argjilo-alevrolitike. Argjilat paraqiten më kompakte, me ngjyrë hiri në bezhë. Trashësia varion 150 – 300 metër.

N13m(d) - Përfaqëson një pako argjilash gips mbajtëse. Midis copërave të gipseve janë ndeshur me shumicë dhe copëra alabastre. Rrallë takohen edhe thjerrëza ranorësh. Trashësia është 300 – 500 metra.

Depozitimet Pliocenike zënë pothuajse të gjithë sipërfaqen e kodrave të Durrësit duke patur, nga Durrësi deri në Currila, një kontakt të drejtpërdrejtë me detin Adriatik. Nga Currilat dhe më në veri (në pjesën ekstreme perëndimore) kontaktojnë me depozitimet Mesiniane. Depozitimet Pliocenike ndahen në dy formacione kryesore: Seria Helmësi (N2h) dhe Seria Rogozhina (N2r).

Në rajonin e qytetit të Durrësit të janë ndeshur vetëm formacionet e Serisë Helmësi (N2h). Këto depozitime ndahen në tre pako litologjike, që nga poshtë lart janë:

N2h(a). – Pakua ranoro- konglomeratike e cila në pjesën e poshtme përfaqësohet nga depozitime ranoro-konglomeratike bazale. Konglomeratet janë të pangopura dhe shprehin fillimin e trangresionit të Pliocenit. Konglomeratet janë disi të çimentuara dhe të ndërthurur me argjila dhe ranorë. Ranoret janë shtresorë dhe disi kompaktë. Më sipër prerja bëhet më argjilo- ranore. Trashësia është nga 350 – 600 metra.

N2h(b). – Pakua argjilo-ranore dhe alevrolito- ranore.

Në këtë pako kryesisht mbizotërojnë argjilat, të cilat janë jo shumë kompakte deri te buta. Janë ngjyrë hiri dhe kanë përmbajtje materiali alevrolitor. Ranorët janë kryesisht thjerrëzorë, me përmasa të thjerrëzave 20- 30 m dhe më shumë në disa raste. Alevrolitet janë masivë deri në shtresorë kompaktë. Trashësia varion nga 600 – 1000 metër.

N2h(c). – Pako argjilo- alevrolitike. Formacionet argjilo-alevrolitike të kësaj pakoje janë kompaktë, ngjyrë hiri në bezhë. Argjilat kanë si karakteristike thyerjen guackore deri ciflore e vende vende shtresore me përmbajtje makrofaune. Në brendësi të kësaj pakoje janë ndeshur thjerrëza të rralla ranorësh. Trashësia e kësaj pakoje është nga 200 – 700 metër.

Depozitimet Kuaternare kanë përhapje të gjerë në qytetin e Durrësit. Ato zënë fushën e Durrësit, zonat plazhore dhe rrëzat e kodrave. Depozitimet Kuaternare paraqiten të ndryshme, në funksion të vendit ku janë formuar. Në fushën e Durrësit ndeshen kryesisht depozitime lagunore-kënetore, në rrëzat e kodrave ndeshen kryesisht

depozitime kolvionale, proluvionale e deluvionale ndërsa në bregun detit, në zonat plazhore, ndeshen depozitime detare.

Q4d – Depozitimet Kuaternare kolvionale - deluvionale dhe proluviale zënë një sipërfaqe të vogël rrëzë kodrave të Durrësit. Ato përbehen nga argjila, alevrite. Trashësia deri 30 metra.

Q4k – Depozitimet Lagunore – kënetore zënë pothuajse të gjithë fushën e Durrësit, ato përbehen nga argjila, alevrite, rëra te imta, mbeturina dhe rrënjë bimësh. Trashësia ~ 50 metra.

Q4 – Depozitimet Kuaternare zënë pjesën e zonave plazhore të rajonit. Ato përfaqësohen nga rëra e zhure.

Rajoni i qytetit të Durrësit bën pjesë në Ultësirën Adriatike. Në këtë rajon veçohen dy struktura: Antiklinali i Durrësit dhe Sinklinali i Durrësit.

Antiklinali i Durrësit bën pjesë në trevën e rrudhosur mollasike Divjakë – Ballaj – Kryevidh- Durrës - Bishti i Pallës. Përfaqësohet nga një varg kodrash, midis të cilave spikat e Durrësit.

Nga punimet sizmike është vërejtur se kjo strukturë pozitive në thellësi komplikohet dhe shoqërohet nga tektonika hedhëse dhe kundra hedhëse, të evidentuara kryesisht në krahun perëndimor të ngjitjes.

Kjo trevë luan rolin e një mburoje për rajonin e Durrësit (sidomos për zonat e ulura te tij) duke zbutur efektin e veprimtarisë së dallgëve. Në sektorin e Gjirit të Durrësit deti ka mposhtur këtë mburojë duke e shkatërruar plotësisht atë. Bregdeti i kodrave të Durrësit është i ballafaquar me rrëshqitje masive, kjo për efekt të ndërtimit të argjilave të Mesinianit dhe të Pliocenit të cilat janë të prirura për rrëshqitjet dhe erozionin.

Në veri qytetit të Durrësit, në det, depozitimet detare Kuaternare shtrihen horizontalisht mbi mollaset e rrudhosura Mio-Pliocene.

Ky mospajtim strukturor krahinor i theksuar dëshmon fazën shtypëse të Pleistocenit të poshtëm në Ultësirën Adriatike. Këtu vihet re se kundër hipja e Durrësit pret madje edhe depozitimet Kuaternare detare që janë deformuar lehtë në përputhje me tavanin e nën shtrirë të depozitimeve Mio- pliocenike). Këto të dhëna demonstrojnë se deformacionet shtypëse veprojnë ende në ditët tona, megjithëse jo kaq të forta si më parë. Neotektonika është shumë e zhvilluar në zonën e studiuar.

Në rrëzë të kodrës së Durrësit në drejtim jug-veri kalon një shkëputje aktive, që ndërton antiklinalin e Durrësit.




Figure 3_Harta skematike gjeologjike e gjirit te Duresit (plansheti 34-K -99 B-b).

Fenomenet gjeodinamike po i rendisim si me poshte.

Nga fenomenet fiziko gjeologjike dhe gjeodinamike per objektin tone vlen te analizohet fenomeni konsolidues i depozitimeve detare te rerave, argjilore –lymore lagunore, fenomeni i lëngëzimit te rerave.

1. Fenomeni i konsolidimit te depozitimeve detare.

Depozitimet e zones ne studim jane kryesisht rerrore dhe me pak surerore. Ato kane shkalle te ndryshme konsolidimi qe varet nga granulometria ,nga prania e materialit te imet suargjilor, sasia e lageshtires dhe nga thellesia e shtresave. Depozitimet me te thella kane shkalle konsolidimi me te larte .Depozitimet argjilore lymore lagunore kane shkalle te ulet konsolidimi pasi mundesie e largimit te ujit nga keto depozitime ka qene e ulet.Shkalla e konsolidimit te shtresave ka ndikim te drejperdrejt ne vlerat e parametrave fiziko mekanik te tyre.

2. Vlerësimi i potencialit të lëngëzimit të truallit

Gjatë një tërmeti, shkalla e tronditjeve që është e nevojshme për shkatërrimin e materialit sipërfaqësor varet nga një sërë faktorësh që përfshijnë tipin e shkëmbit rrënjësor dhe të truallit, pjerrësinë, ngopjen me ujë etj. Dy tipe kryesore të shkatërrimit të materialit sipërfaqësor që mund të pritët në zonën ku ndodh një tërmet relativisht i fortë janë lëngëzimi i truallit dhe ulja apo zhytja e truallit nga kompaktësimi.

Lëngëzimi si fenomen ndodh kur valët sizmike tërthore përshkojnë shtresat e truallit të ngopur me ujë, prishin strukturën e tyre granulare, ulin gradualisht sforcimin efektiv dhe e transferojnë ngarkesën në ujin e poreve, duke shkaktuar kështu rritjen e presionit në pore. Për shkak të kohës së shkurtër që ndodh i gjithë ky proces,

presioni në pore arrin në nivelin kritik kur sforcimi efektiv bëhet gati zero. Në këto kushte, materiali granular sillet më tepër si fluid I ngjeshur se sa si material solid. Për shkak se sforcimet tërthore të induktuara nga tërmeti tentojnë të bëhen më të mëdha pranë sipërfaqes së truallit, këtu ndodh fillimisht fenomeni I lëngëzimit dhe më pas përparon gradualisht për në shtresat më në thellësi. Në shtresat sipërfaqësore, pasi materiali është lëngëzuar dhe është çliruar shtesa e presionit në pore, trualli vendoset në një formë më të ngjeshur. Duke qenë se më në thellësi presioni në pore është ende duke u rritur, kjo bën që rëra dhe uji të shpërthejnë në drejtim të sipërfaqes. Në provalaboratorike lëngëzimi ndodh në rëra të imëta por në realitet ndodh gjithashtu edhe në rëra më kokërrtrashë. Bregdeti i rrafshët Adriatik, me shumë plazhe rëre dhe laguna, ndërtohet nga depozitime të reja Kuaternare (lymra, surëra, suargjila, rëra) me trashësi të madhe (100 – 150m) dhe nivel të cekët të ujërave nëntokësorë. Duke qenë edhe një nga zonat më sizmike të vendit dhe duke patur këtë kushte gjeologjike, janë vërejtur shumë fenomene të lëngëzimit të truallit në raste të ngjarjeve të fuqishme tërmetore. Gjatë tërmeteve të fortë të shekullit XX janë vërejtur shumë dukuri lëngëzimi si rrëshqitje horizontale dhe ulje trualli, shatërvanë uji dhe rëre (pseudo vullkane rëre) dhe çarje trualli etj. Bazuar në informacionin e marrë nga studime të më hershëm nga shpimet e kryera duke përdorur vlera referencë të parametrave gjeoteknikë të këtyre shtresave, sheshi i studimit mund të konsiderohet me mundësi të lartë të ndodhjes së fenomenit të lëngëzimit në rast të ngjarjeve të fuqishme tërmetore. Për më tepër, sheshi i studimit bën pjesë në zonën e mundësi deformimesh të mëdha në sipërfaqe të truallit në rast të tërmeteve të fortë.

4 TË DHENAT HIDROLOGJIKE TË ZONËS NË STUDIM

Pjesa më e rëndësishme e kantierit është niveli i ujërave nëntokësore për projektimin e strukturave. Bazuar në vizitën në terren dalim në përfundimin dalim në përfundimin që kemi një përzierje të ujit nëntokësor me atë të kripur. Për këtë rast marrim një kampion ujë për analiza në laborator dhe e paraqesim më poshtë.

4.1 Niveli i Ujërave Nëntokësor

Ujrat sipërfaqesore te zones rezidenciale jane ato te rreshjeve dhe ne pergjithesi jane te vrullshme dhe shpesh ne forme stuhie te perkoheshme, karakteristike kjo per gjithe zonen bregdetare te Duresit. Ujrat e rreshjeve filtrojne lehte nentoke pasi teresia e sipërfaqes eshte me rera. Ne raste te rralla mund te krijohen pellgje te perkoheshme me uje, ne vartesi te sasise te rreshjeve. Ujrat sipërfaqesore ne rast rreshesh risin veshtiresine e punimeve ne gropat e themeleve pasi i mbushin me rere ato nga anet(faqet) e gropave. Meqenese depertimi i ujrave te rreshjeve eshte i menjehershem duhet qe gjeresia e trotuareve te objekteve te jete me e gjere per te rritur cilesine e ambienteve turistike.

Ujrat nëntokësore jane verifikuar nga shpimet perkatesese dhe jane ne thellesine te ceketa nga -1.7 meter. Edhe ne stinet me rreshje ritet pak nen ndikimin e nivelit te zones fushore ne pergjithesi. Nga studime te meparshne eshte konstatuar se ujrat nëntokësore kane levizje te ngadalte nga kontinenti drejt detit, keto ujra sa me shume te afrohen vijes detare risin nivelin e krypshmerise.




Figure 4_Harta skematike hidrogjeologjike e gjirit te Duresit (plansheti 34-K -99 B-b)

5 INFORMACION MBI SIZMICITETIN E ZONËS

Për sa i përket sizmicitetit, rajoni i Durrësit është në zonën sizmologjike e cila mund të gjenerojë tërmete deri në IX ballë (MSK) sipas hartës së Gjeoriskut të Republikës së Shqipërisë, pra në zonën me veprimtari të theksuara tërmetesh.

Ka të dhëna arkivore që tregojnë se Qyteti i Durrësit të lashtë është goditur disa herë nga tërmete të fuqishëm të cilët kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në njerëz dhe në materiale.

Nga kronikat del se Durrësin e kanë rrënuar tërmetet e viteve 177 (para Krishtit), 334 dhe 345 (pas Krishtit), 506, 1273, 1279, 1869, 1870.

Disponohen të dhëna për tërmetin e vitit 1273, ku thuhet se qyteti prej 25 000 banorësh i asaj kohe u shkatërrua krejtësisht. Pati shume viktima në njerëz dhe mjaft të tjerë u larguan nga qyteti për në vendbanime të tjera. Kronikat kanë thënë se kjo ngjarje solli si pasojë humbjen e rëndësisë së qytetit të Durrësit si qytet i madh në Adriatik.

Me ngritjen e stacioneve sizmologjike, sidomos nga fillimi i shekullit të XX, në Evropë, u mundësua evidentimi instrumental i tërmeteve të ndodhur.

Nga të dhënat e përpunuara rezulton se rajoni i qytetit të Durrësit është goditur nga tërmete mjaft dëmtuese. Ndër më të fortët mund të përmendim në 17 Dhjetor 1926 me $M_s = 6.2$ dhe $I_o = IX$ (MSK-64), i cili shkatërroi mjaft shtëpi banimi në Durrës, Shijak e Kavajë.

Një ndër tërmetet më të fortë, të gjeneruara nga kjo thyerje, që ka goditur qytetin e Tiranës është ai i 26.11.2019 me $M_s = 6.4$ dhe intensitet epiqendror $I_o = IX$ ballë MSK-64. Efekti i këtij tërmeti në sipërfaqe tregoi edhe njëherë rëndësinë e ndikimit të kushteve të truallit në intensitetin e tërmeteve mesatarë deri të fortë.




Figure 5_ Epiqendrat e tërmeteve me $M_s \geq 4.0$ për periudhën 1970 – sot në rajonin përreth Durrësit.

Vlerësimi probabilitar i rrezikut sizmik të sheshit të ndërtimit është bërë për kushtin e dëmtimeve të kufizuara (me probabilitet tejkalimi 10% në 10 vjet, periudhë tejkalimi 95 vjet) dhe për kushtin e mos shembjes (probabilitet tejkalimi 10% në 50 vjet, periudhë tejkalimi 475 vjet) sipas kërkesave të VKM Nr. 1162 Pika 1.1 "Kërkesa bazë në zbatim të standardit të projektimit për vlerësimin e rrezikut sizmik (si kusht minimal)". Bazuar në rekomandimin e IGJEO, vlerat e rrezikut sizmik për këto nivele performance paraqiten në Tabelë.

	10% në 10 vjet (PP =95 vjet)	10% në 50 vjet (PP =475 vjet)
PGA	0.119	0.259

6 PËRSHKRIMI I STUDIMIT GJEOTEKNIK TË ZONËS

6.1 Njesite Gjeoteknike

Dheu konsistonte në një shtresë të sipërme suargjilore të butë në ngjyrë gri dhe të ngopur me ujë, pasuar nga një shtresë më e thellë rëre ngjyrë gri me dendësi mesatare, dhe një shtresë argjile lymore plastike te bute të fortë dhe aleuriti deltinor me kokrriza ranore të rralla dhe gurë të bardhë të lëmuar. Shtresat e holla me rërë të dendur mesatare janë vërejtur herë pas here.

Table -1_ Stratigrafia e truallit te dy shpimeve.

Shtresa 1:	Argjila pluhurore me ngjyre gri me shume lageshtire deri te ngopura me uje jane pak deer mesatarisht te ngjeshur	$[6 \leq \text{SPT} \leq 9]$
Shtresa 1:	Argjila lymore deri suargjila te leta me ngjyre gri-te kalter plastike te buta pak te ngjeshuar.	$[7 \leq \text{SPT} \leq 10]$

6.2 Procedurat e Operimit per Karakterizimin Gjeoteknik

6.2.1 Pershkrimi i Dherave

Table -2_Tipi I dherave

Emertimi	Grain size		Kriteri klasifikimit
Blloku	> 200		Te dallueshme me sy te lire
Gure	200÷60		
Zhavorre	Te trasha	60÷20	
	Mesatare	20÷6	
	Te imta	6÷2	
Rere	Te trasha	2÷0.6	
	mesatare	0.6÷0.2	
	Te imta	0.2÷0.6	
Surera	0.06÷0.002		Dukshme me sy të lirë nëse është trashë. Jo shumë plastike, duke u zgjeruar, pak kokrrizë në prekje, duke u shpërbërë shpejt në ujë. Megjithëse kohezive, kthehet te pluhur me gishta
Argjile	< 0.002		Fragmente të thata të thyer që nuk pudrosin me gishta. Ngadalë shpërbëhet në ujë. Plastik i butë me prekje, jo duke u zgjeruar. Ngjit gishtat dhe tharje të ngadaltë. Tkurret kur thahen

Toke organike		Përmbajnë një përqindje të konsiderueshme të lëndës organike bimore
Torfe		Mbetjet kryesisht prej druri jo të mineralizuara, ngjyra e errët, densitet i ulët

Table -3_Llogaritja

Emertimi	Rrumbullakimi	Pershkrimi
Angular	0-0.15	-//-
Sub-angular	0.15-0.25	Ruajtja e formës origjinale me rrumbullakim të theksuar
Sub-rounded	0.25-0.40	Rrumbullakim i konsiderueshëm dhe zona e zvogëluar sipërfaqësore e kllapave
Rounded	0.40-0.60	Largimi i sipërfaqeve origjinale, me disa sipërfaqe të sheshta
Much rounded	0.60-1	Sipërfaqja e përcaktuar plotësisht nga kthesat e rrumbullakosura mirë

Table -4_Konsistenca e dherave kohezive

Emertimi	Rezistenca nga Penetrometri (kg/cm ²)	Testet manuale
Pa konsistence	< 0.25	Leshon uje kur shtypet
Jo me shume konsistente	0.25÷0.5	Lehtesisht I germueshem
E moderuar	0.5÷1.0	I formueshem nga gishtat me pak përpjekje. Disa rezistencë ndaj gërmimeve
konsistente	1.0÷2.0	Jo i formueshem me gishta. Vështirë të gërmohet
Shume konsistente	> 2.0	Shumë rezistent ndaj formimit me gishta dhe shumë i vështirë për tu gërmuar

Table -5_Trashesia e dherave kokrrizore

N _{SPT}	Vlerësimi I Gjendjes	Testet Manuale
------------------	----------------------	----------------

0-4	Te holla	Lehtesisht I germueshem
4-10	Jo shume te trasha	Me shume lehtesisht I germueshem se sa I penetrueshem me shufer
10-30	Mesatarisht ne menyre te moderuar	I germueshem ose I penetrueshem me veshtiresi
30-50	Te trasha	Penetrim I veshtire, kapje
> 50	Shume te trasha	Me veshtiresi te kapshme

6.2.2 Vetite fiziko mekanike te shtresave

Seksionet vijuese tregojnë te dhena te shtresave te dobishme për përcaktimin e tipareve gjeoteknike të dherave përgjatë shtegut në fjalë. Informacionet ndahet sipas njësive gjeoteknike të përshkruara në kapitullin e mëparshëm. Me poshte jane te paraqitura rezultatet e shtresave.

Shtresa 1: Suargjila pluhurore me ngjyre gri me shume lageshtire deri te ngopura me uje jane pak deri mesatarisht te ngjeshur

Perberje granulometike:

Zhavor %	0
Rere %	0.7
Pluhur %	74.9
Argjil %	24.4
Lageshtia natyrale	34.9%

Plasticitetit:

Limiti I siperm I plasticiteti	34.4
Limiti I poshtem I plasticiteti	26.5
Indeksi I plasticitetit	7.9

Peshat

Pesha volumore	19.0 kN/m ³
Pesha e thate	14.1 kN/m ³
Pesha Specifike	26.8 kN/m ³

Klasifikimi:

USCS	ML
------	----

Prerja e drejte:

Kohezioni pa drenim	$C_u = 64 \text{ kPa}$
Kendi i ferkimit te brendeshem	$\phi = 21.0^\circ$
Kohezioni	$C = 25 \text{ kPa}$

Aftesia mbajtese e lejuar $\sigma = 140 \text{ kPa}$

Shtresa 3:

Argjila lymore deri suargjila te leta me ngjyre gri-te kalter plastike te buta pak te ngjeshuar.

Perberje granulometike:

Zhavor %	0
Rere %	1.7
Pluhur %	75.2
Argjil %	23.1
Lageshtia natyrale	35.5%

Plasticitetit:

Limiti I siperm I plasticiteti	26.5
Limiti I poshtem I plasticiteti	8.20
Indeksi I plasticitetit	18.3

Peshat

Pesha volumore	18.6 kN/m^3
Pesha e thate	13.7 kN/m^3
Pesha Specifike	25.8 kN/m^3

Klasifikimi:

AASHTO	A7-6
USCS	CL

Prerja e drejte:

Kohezioni pa drenim	$C_u = 300 \text{ kPa}$
Kendi i ferkimit te brendeshem	$\varphi = 14.5^\circ$
Kohezioni	$C = 40 \text{ KPa}$
Aftesia mbajtese e lejuar	$\sigma = 150 \text{ kPa}$

6.3 Perfundime

1. Zona ne studim ka depozitime detare
2. Niveli i ujit nentokesore eshte -1.7 meter




Figure 6 - Planimetria e zones se projektit.

NDËRHJRJE PËR RRITJEN E OFERTËS TURISTIKE DHE PËR PËRMIRËSIMIN FUNKSIONAL DHE ESTETIK TË BREGDETIT

VENDNDODHJA : DURREËS, SHQIPERI

RAPORTI HIDROLOGJIK

Permbajtja

1	INFORMACION I PERGJTHSHEM MBI PROJEKTIT	3
1.1	Qellimi i projektit	3
2	STUDIMI HIDROLOGJIK	4
2.1	Klima	4
2.2	Te dhena Hidrologjike.....	7
3	PROPOZIMI I PROJEKTIT	12
3.1	Kanalizimet e ujrave te zeza	12
3.2	Furnizimi me uje.....	13

1 INFORMACION I PERGJTHSHEM MBI PROJEKTIT

1.1 Qellimi i projektit

Ky projekt ka për qëllim të transformojë zonën bregdetare të qytetit të Durrësit në një destinacion bashkëkohor turistik, rekreativ dhe urban, përmes ndërhyrjeve arkitekturore dhe urbane të planifikuara me kujdes. Ai përfshin zgjerimin e plazhit ekzistues, krijimin e një parku linear të gjelbër përgjatë vijës bregdetare, zhvillimin e hapësirave publike shumëfunksionale dhe integrimin e infrastrukturave të reja rekreative dhe sportive. Gjatësia e zonës së ndërhyrjes është rreth 2.8 km, me një zgjerim të vijës bregdetare deri në 100 metra drejt detit, duke krijuar hapësira të reja publike për banorët dhe vizitorët.



Figure 1 – Vendndodhja e projektit

2 STUDIMI HIDROLOGJIK

2.1 Klima

2.1.1 Zona Klimatike

Zona e studimit ndodhet brenda zonës klimatike Mesdhetare të Ultësirës. Kështu, sasia vjetore e reshjeve varion midis 950–1200 mm. Rënia e dëborës është një fenomen i rrallë dhe shtresa e qëndrueshme e dëborës pothuajse nuk vërehet kurrë. Temperaturat minimale absolute variojnë midis -3 deri në -5 °C; vetëm në raste shumë të rralla mund të regjistrohen vlera më të ulëta. Periudha me ngrica është e shkurtër dhe numri i ditëve me ngrica mund të arrijë deri në 12–15 në vit, gjatë të cilave temperaturat minimale zbresin nën 0°C.

Era fryn përgjithësisht nga dy drejtime. Gjatë sezonit të ftohtë mbizotëron era nga jugu-lindja dhe veriu, ndërsa gjatë sezonit të ngrohtë mbizotëron era nga drejtimi veriperëndimor. Shpejtësitë maksimale të erës në këtë zonë gjatë sezonit të ngrohtë arrijnë vlera prej 10–15 m/s, ndërsa gjatë sezonit të ftohtë rreth 25–30 m/s.




Figure 2 – Zonimi klimaterik, Albania

2.1.2 Temperatura

Temperatura e ajrit është një element i rëndësishëm klimatik, i cili pasqyron sasinë e energjisë diellore në afërsi të Tokës. Në tabelën dhe grafikën e mëposhtme paraqiten temperaturat mesatare mujore të matura në Stacionin e Kamzës. Nga këto të dhëna vërehet se vlera mesatare maksimale arrihet në muajin korrik (23.4 °C), ndërsa vlera minimale në muajin janar (6.5 °C). Vlera mesatare për të gjithë vitin është 14.9 °C.

Figure 3 – Temperaturat mesatare mujore të ajrit - tabelle

Months	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Year
Temp. °C	6.5	7.8	9.9	13.1	17.6	21.4	23.4	23.3	20.3	15.9	11.8	7.9	14.9




Figure 4 – Temperaturat mesatare mujore të ajrit

2.1.3 Kohëzgjatja e muajve me diell

Në grafikën e mëposhtme paraqiten vlerat mujore të kohëzgjatjes së diellit në orë për stacionin e Kamzës. Nga këto të dhëna vërehet se vlerat maksimale të këtij elementi regjistrohen në korrik, ndërsa vlerat minimale në dhjetor. Vlera mesatare për gjithë vitin është 2613 orë.




Figure 5–Kohëzgjatja e muajve me diell

2.1.4 Lageshtia

Lagështia e ajrit është gjithashtu një element meteorologjik i rëndësishëm, i cili ndikon në trafikun rrugor. Në tabelën e mëposhtme paraqitet shpërndarja ndërvjetore e këtij elementi. Nga këto të dhëna vërehet se vlera mesatare e lagështisë regjistrohet gjatë sezonit të dimrit (79–80%), ndërsa vlera minimale gjatë sezonit të ngrohtë (63–67%). Gjithashtu paraqitet shpërndarja ndërvjetore e lagështisë relative, ku shihet se vlerat e këtij elementi luhaten brenda një intervali të vogël..

Figure 6 – Lageshtita relative tabele(%)

Months	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Year
Rel. Humidity	77	75	75	76	76	70	63	67	73	76	80	80	74




Figure 7 – Lageshtita relative (%)

2.1.5 Reshjet

Reshjet janë një element i rëndësishëm për projektimin, veçanërisht të dhënat mbi intensitetin e reshjeve. Vlerat mujore të reshjeve për një vit mesatar paraqiten në tabelën më poshtë, të ndjekura nga paraqitja grafike e shpërndarjes së tyre ndërvjetore.

Nga këto të dhëna vërehet se vlerat mesatare maksimale regjistrohen gjatë muajve të dimrit, ndërsa vlerat minimale në muajin korrik. Vlera mesatare për të gjithë vitin është 1299 mm. Numri i ditëve me shtresë reshjesh mbi 0.1 mm varion midis 85 dhe 100 ditëve. Në përgjithësi, reshjet maksimale nuk janë shiu i rrëmbyeshëm.

Rënia e dëborës është një fenomen i rrallë dhe një shtresë e rëndësishme dhe e qëndrueshme e dëborës nuk vërehet në këtë zonë. Shtresa maksimale e dëborës zakonisht arrin vlerën 5–10 cm dhe shumë rrallë 15–17 cm.

Figure 8 – Shpërndarja ndërvjetore e reshjeve ne tabele (mm)

Months	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Year
Precipitations	151	121.5	126.5	110.4	92.9	65.2	46.2	57.9	80.8	110.6	138.1	158.7	1299




Figure 9 – - Shpërndarja ndërvjetore e reshjeve (mm)

Mesatarisht në këtë zonë, ka një rritje të reshjeve vjetore prej rreth 110 mm për çdo 100 m lartësi. Numri i ditëve me reshje ≥ 1.0 mm varion nga 1.6 ditë në korrik deri në 9.1 ditë në nëntor. Gjatë një viti, ka mesatarisht 76.9 ditë me reshje ≥ 1.0 mm

2.2 Te dhena Hidrologjike

Ivestigimi i reshjeve të mëdha është thelbësor për të përcaktuar intensitetin klimatik dhe probabilitetin e ngjarjeve stuhore. Është e nevojshme të nxirret rrjedhja maksimale me një probabilitet të specifikuar tejkalmi, gjë që është e domosdoshme për përfundimin e projektimit të sistemit të ujërave të shiut në zonë.

Klima e Shqipërisë, në përgjithësi, është Mesdhetare, me një farë ndikimi kontinental në zonat malore në pjesën veriore, qendrore dhe jugore të vendit. Shteti kombinon një ultësi bregdetare në Perëndim me male relativisht të larta: pika më e lartë arrin 2751 m në kufirin trefish me Jugosllavinë dhe Maqedoninë, ndërsa shumë maja tejkalojnë 2000 m në pjesët veriore, qendrore dhe jugore të vendit. Reshjet vijnë kryesisht me erën nga jug-perëndimi dhe bien sipas pengesave që hasin, gjë që jep një larmi klimash dhe modeleve të reshjeve në rajone të ndryshme të vendit.

Siç tregojnë të dhënat e nxjerra nga stacionet me 30 vite vëzhgim të vazhdueshëm: reshjet mesatare vjetore janë rreth 1485 mm; modeli sezonal është shumë i qëndrueshëm, me korrikun, ndonjëherë gushtin, si muaji më i thatë dhe nëntorin, ndonjëherë dhjetorin, si muaji më i lagësht.

2.2.1 Reshjet Maksimale

Mesatarja e reshjeve (si në shkallë vjetore, ashtu edhe për çdo sezon) paraqitet në tabelën e mëposhtme; të dhënat ekstreme të regjistruara jepen në kolonën e fundit. Reshjet mesatare vjetore variojnë nga 700 mm në juglindje të Shqipërisë deri në 3500 mm në veri, me një vlerë mesatare për gjithë vendin prej 1485 mm (Bogdani dhe Selenica, 1997). Reshjet maksimale ditore në Alpe arrijnë 300–400 mm, ndërsa në zonat malore jugore janë 200–300 mm.

Reshjet vjetore shtrihen brenda intervalit 1000–2000 mm për vit, me vlera më të larta në zonat malore të ekspozuara ndaj rrymave perëndimore dhe jug-perëndimore. Vlerat tregojnë se – përveç variabilitetit hapësinor – reshjet mesatare vjetore janë zakonisht të larta. Një hartë e shpërndarjes hapësinore të lartësisë së reshjeve 24-orëshe me probabilitet 1% paraqitet në figurën më poshtë.




Figure 10 – Shpërndarja hapësinore e reshjeve maksimale ditore në të gjithë Shqipërinë.

2.2.2 Pluviometra dhe Pluvigrafe

Monitorimi i elementeve meteorologjike në Shqipëri, i cili është shumë i rëndësishëm për të evidentuar variabilitetin klimatik si në hapësirë ashtu edhe në kohë, ka filluar që nga fundi i shekullit XIX. Ai u themelua dhe u forcua në vitet 1950, duke u shtrirë në të gjithë territorin dhe njëkohësisht duke rritur numrin e elementeve meteorologjike të matur. Pas “kulmit” të tij në vitet 1980 (rreth 230 stacione meteorologjike), rrjeti kombëtar meteorologjik në Shqipëri u reduktua ndjeshëm në vitin 1990 dhe sot është rritur sërish deri në 126 stacione meteorologjike.

Në përgjithësi, teknologjia aktuale e matjes që përdoret për disa elemente meteorologjike është shumë e vjetër dhe gabimi i matjes është i konsiderueshëm. Përveç kësaj, mungesa e pajisjeve mbetet një problem.

Një hartë e pluviometrave dhe pluviografëve për gjithë rajonin paraqitet në figurën më poshtë.




Figure 11 – Rrjet I ekzistues i Pluviometra dhe Pluvigrafe ne Shqiperi

2.2.3 Kurbe intesiteti-Kohëzgjatje- Frekuence

Reshjet e dendura zakonisht përshkruhen përmes përdorimit të kurbave Intensitet–Kohëzgjatje–Frekuencë (IDF). Një kurbë Intensitet–Kohëzgjatje–Frekuencë është një përfaqësim grafik ose matematikor i probabilitetit që një intensitet mesatar i caktuar i reshjeve të ndodhë (zakonisht brenda një viti).

Intensiteti i reshjeve (mm/orë), kohëzgjatja e reshjeve (sa orë ka rënë shiu me atë intensitet) dhe frekuenca e reshjeve (sa shpesh përsëritet kjo stuhi shiu) janë parametrat që përbëjnë boshtet e grafikut të kurbës IDF.

Kurbat IDF të reshjeve nxirren përmes vëzhgimit të maksimumit vjetor të reshjeve për periudha të ndryshme kohore.

Të dhënat e reshjeve maksimale do të përfaqësohen nga stacioni meteorologjik i vendosur pikërisht në zonën e projektit “DURRËS PORT”. Intensiteti maksimal i reshjeve me probabilitete të ndryshme është marrë për këtë stacion nga: “Manuali i Reshjeve Maksimale me Probabilitete të Ndryshme”, i botuar nga Instituti Hidrometeorologjik Shqiptar në vitin 1985. Më poshtë janë paraqitur kurbat IDF.

Figure 12 Tabele permbledhese e maksimumit me probilitete te ndryshme (Dures Port station)

Duration [hours]	Probability [%]					
	1	2	5	10	20	50
	Intensity [mm/h]					
24	8.3	7.4	6.3	5.4	4.5	3.1
12	13.8	12.3	10.3	8.8	7.3	4.9
6	21.2	19.2	16.3	14.2	11.8	8.3
2	47.0	42.5	36.5	32.0	27.0	19.5
1	73.0	66.0	57.0	50.0	43.0	32.0
0.50 (30 minutes)	112.0	100.0	86.0	76.0	64.0	48.0
0.33 (20 minutes)	133.3	121.2	106.1	93.9	81.8	60.6
0.1667 (10 minutes)	186.0	168.0	150.0	132.0	114.0	90.0
0.08335 (5minuta)	247.9	222.0	188.0	162.0	134.5	92.4




Figure 13 – - IDF curves, Durres .


3 PROPOZIMI I PROJEKTIT

3.1 Kanalizimet e ujërave të zeza

Në kuadër të projektit, parashikohet gjithashtu ndërtimi i një rrjeti kanalizimesh për ujërat e zeza, me qëllim sigurimin e një sistemi efikas dhe të qëndrueshëm për largimin e ujërave të ndotura. Rrjeti do të mbledhë ujërat e zeza nga platformat e reja të ndërtuara, duke i drejtuar ato drejt pikave ekzistuese me sistemin qendror të kanalizimeve të qytetit. Traseja dhe dimensionet e kanaleve janë projektuar në përputhje me standardet teknike, me objektivin për të garantuar funksionim të sigurt dhe mirëmbajtje të lehtë.



Figure 14 – - Plan KUZ



3.2 Furnizimi me uje

Për platformat me funksione të ndryshme të parashikuara përgjatë vijës bregdetare, parashikohet ndërtimi i një rrjeti furnizimi me ujë, i lidhur me tubacionet ekzistuese të qytetit. Rrjeti do të sigurojë shpërndarje të qëndrueshme dhe të kontrolluar të ujit, në përputhje me kërkesat specifike të çdo zone funksionale. Traseja dhe dimensionet e tubacioneve janë përcaktuar bazuar në nevojat hidraulike, duke garantuar presion të mjaftueshëm dhe mirëmbajtje të lehtë.



Figure 16 – Plani I furnizimit me uje .




Figure 17 – Pusete tip ujesjellesi

NDËRHJRJE PËR RRITJEN E OFERTËS TURISTIKE DHE PËR PËRMIRËSIMIN FUNKSIONAL DHE ESTETIK TË BREGDETIT

VENDNDODHJA : Durrës, Shqipëri

RAPORTI I LLOGARITJEVE STRUKTURE

Permbajtja

1	INFORMACION I PERGJTHSHEM MBI PROJEKTIT	3
1.1	Projektimi Struktural.....	3
2	KERKESAT SIPAS EUROCODEVE	5
2.1	Jetëgjatësia e projektuar e veprës	6
2.2	Materialet që duhen përdorur në ndërtim	7
